



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.4(441)

PRILL 2025

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

### 106 VJETORI I LINDJES

## GJENERAL PARLLAKUN, JETA DHE VEPRA E TIJ E VESHI ATË ME PAVDEKËSI...



Nga HALIL RAMA – Mjeshtër i Madh

FAQE 4

### 80 - VJETORI

## MINISTRI VENÇU: SHKOLLA “SKËNDERBEJ”, VATËR E EDUKIMIT TË BREZAVE



FAQE 7

### OPINION

## “24 MARS I BOMBARDIMEVE TË SHBA/NATO PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS”!



Gjeneral @ Piro Ahmetaj

FAQE 4

*Federata e Paqes Universale Shqipëri, vlerëson me titull nderi kryetaren e OBVLP*

# TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU

## “AMBASADORE PËR PAQE”

26 VJET MË PARË

### BOMBARDIMET E NATO-s NGJARJE HISTORIKE

Nënshkrimi i Deklaratës për thellim të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, midis Kosovës dhe dy shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Shqipërinë dhe Kroacinë që janë pjesë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), me siguri do të shpejtoj integrimin e Kosovës në strukturat evropiane-atlantike

Nga Bashkim Hisari

FAQE 10



• “Në botë numërohen mbi 150 mijë ambasadorë të paqes. Unë ndihem krenare që po i bashkohem më shumë se 1000 ambasadorëve të paqes në Shqipëri e Kosovë që kontribuojnë në sferën akademike, fetare, në shoqërinë civile etj”, tha ndër të tjera kryetarja e OBVLP-së

FAQE 3

### LIBRI I 28-TË I HALIL RAMES

“Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave” promovohet me 14 prill 2025 në Kinema “Maks Velo” Laprakë



Nga Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj - Mjeshtër i Madh

FAQE 16

## Patriotizmi, vlerë e përhershme e dibranit

### HISTORIA

## BRIGADA E VIII-të S SHKROI ME GJAK TRIUMFIN NDAJ FASHIZMIN

FAQE 2

### ASC

## KUVENDI DHE BESA SHQIPTARE NË SENICË TË DELVINËS

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 13

### 110 VJETORI I VDEKJES

## “O BAJRAM - BAJRAK I GJALLË”

Nga, Gëzim Prengzi

FAQE 5

### IN MEMORIAM

## YMER PUKA, INTERNACIONALIST I SHQAR

XHEMAL MEÇI – Mjeshtër i Madh

FAQE 3

### OPINION

## TOFIK RAMA I TEPELENËS DHE SHOKËT E TIJ TË USHTRISË

NGA MEVLUD BUCI

FAQE 12

### REPORTAZH

## DURRËS, 7 MARS I BËN BASHKË MËSUES, NXËNËS DHE SHKRIMTARË

Nga Nuri Bufi

FAQE 13

### REFLEKSIONE

## KRENAR NË 80 VJETORIN E LAVDISHËM TË SHKOLLËS USHTARAKE “SKËNDERBEJ”

FAQE 6

### SUPLEMENTI LETRAT

## RRUGA E ARBRIT

Nga Sakip Cami

## PËRMBUSHJA E MISIONIT

Ese nga Neki CAKO

FAQE 11

## HISTORIA

81-vjetori i krijimit të një prej formacioneve më të mëdha e më të shquara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare

# Brigada e VIII-të S shkroi me gjak triumfin ndaj fashizmit

Tetëdhjetënjë vjet më pare, më 25 Prill 1944, në një lëndinë të rrethuar me lisa, me një bukuri të rrallë natyrore, në Sheper të Zagorisë u formua Brigada e VIII-të Sulmuese. Fillimisht ajo pati një efektiv prej 950 partizanë të ardhur nga njësitë partizane të Grupit të parë të Kurveleshit, Çeta "Koto Haxhi", Batalioni "Misto Mame", Batalioni "Thanas Ziko" e të tjerë partizanë nga Qarku i Gjirokastrës, që të gjithë të sprovuar në luftime kundër armikut. Me krijimin e Brigadës u formuan katër batalione me nga katër kompani, me një efektiv prej rreth 200-250 vetë.

Komandant Brigade u caktua Asaf Dragodi, Zv/Komandant Koço Gjeci, Komisar Qazim Kondi dhe Zv/Komisar Rrahman Parllaku. Njëkohësisht u caktuan edhe komandantët e batalioneve e të kompanive.

Në formimin e saj morën pjesë partizanë e partizane me përvojë lufte dhe që kishin lënë gjurmë heroizmi e gjaku në Luftën Çlirimtare gjatë viteve 1942 - 1943.

Fillimisht, Brigada e 8-të S e nisi operacionin kundër armikut në mbrojtje të delegatëve dhe mjediseve ku po përgaditej Kongresi Historik i Përmetit, duke zënë pozicione luftime nga Ura e Dragodit, Rëzë, Lunxheri, Gryka e Çajupit, Gryka e Salckës, Pogon, Dhembel, Nemeçkë e deri në fshatrat e Përmetit si Çaçovë, etj.

Operacioni i Qershorit 1944 ishte prova më e vështirë, por edhe kalitja vendimtare për Brigadën e 8-të Sulmuese. Komanda e Brigadës dhe ato të batalioneve morën të gjitha masat organizative e operative për vazhdimin e luftimeve, deri në çlirimin e plotë të vendit.

Më 5 qershor 1944 forcat e Brigadës së 8-të i zunë pritë një kollone gjermane me mbi 900 vetë që vinin nga Greqia. Luftimet u zhvilluan të ashpra në Skore, Sopik e Çatister nga Batalioni i 3-të që ishte në rrezik rrethimi. Një trimëri të rrallë tregoi skuadërkomandanti Ormen Boro, i cili me automatik e bomba dore u hodh si rufe në llogoren e armikut në Sopik, duke asgjësuar një mitraloz të rëndë dhe duke vrarë disa gjermanë. Pas përlëshjesh të ashpra ai u vra edhe vetë duke mbetur përjetë në altarin e lirisë.

Në këtë situatë armiku pësoi çoroditje, ndërsa forcat partizane po përparonin dukshëm. Nga luftimet e suksesshme të forcave të Batalionit të 3-të dhe të kompanisë së 2-të në Skore, armiku u detyrua të tërhiqej, duke lënë në fushën e betejës 11 gjermanë të vrarë. Nga radhët e partizanëve u vranë 5 veta dhe u plagos komandanti i kompanisë së 2-të Mustafa Demiri.

Më 13 qershor '44 Batalioni i 3-të sulmoi në befasi një njësi armike në



- ***Brigada e 8-të Sulmuese ka qenë një nga formacionet partizane më të suksesshme gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ajo u krijua nga çeta të ndryshme partizane, të cilat kishin vite që luftonin kundër pushtuesve dhe mori pjesë në çlirimin e qyteteve, si Gjirokastra, Berati, Tirana etj***

Grykën e Këlcyrës, në kohën kur ishin duke ndarë dhe ngrënë darkën. Armiku i çoroditur e në panik la në këtë luftim të papritur mjaftë të vrarë e të plagosur, ndërsa nga ana jonë nuk pati dëmtime.

I tërbuar nga humbjet e njëpasnjëshme, armiku kundërsulmoi forcat e Brigadës së 8-të me forca të shumta nga Gjirokastra. Prej datës 17-26 qershor 1944 për afro dhjetë ditë u zhvilluan luftime të ashpra në Lunxhëri, Çajup, Pogon e Zagori. Në kodrat e Çajupit ra mitralieri trim nga Mallakastri, Imer Xhaferi dhe u plagos partizania Keno Çarçani.

Në këto luftime, Brigada bëri një tërheqje taktike në malin e Dhëmbelit. Atje u riorganizua dhe më 30.06.1944 sulmoi përsëri gjermanët në Zagorie, të cilët u detyruan të tërhiqen në Gjirokastrë, duke lënë mbi 20 të vrarë e të plagosur.

Më 19.7.44 Brigada sulmoi sërish armikun në Gjirokastrë. Batalioni i 3-të sulmoi natën në befasi duke i shkaktuar armikut humbje të shumta në njerëz e mjete, ndërsa nga forcat partizane ra heroikisht zv/komisari i kompanisë Hito Gaçe dhe u plagos partizani Ollav Dhame.

Në Gusht '44 Brigada e 8-të mori

urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm për të çliruar Konispolin. Luftimet u zhvilluan të ashpra dhe pas 48 orësh (më 28 gusht '44) Konispoli u çlirua. Armiku la më se 10 të vrarë, dhjetra të plagosur; U zunë 21 robër, mbi 17 pushkë e dy mitralozë të lehtë. Ndërkohë u plagos skuadërkomandanti Fejzo Rexhepi nga Mallakastri, u vranë katër partizanë, ndër të cilët edhe komandanti trim i Kompanisë së 3-të Razo Zeneli.

Kjo brigadë ka luftuar për çlirimin e qyteteve të Gjirokastrës, Beratit, Lushnjës dhe Tiranës, si dhe jashtë kufijve administrativë shqiptarë, duke dhënë një kontribut të madh edhe në çlirimin e viseve kosovare.

Brigada e 8-të Sulmuese ka qenë një nga formacionet partizane më të suksesshme gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ajo u krijua nga çeta të ndryshme partizane, të cilat kishin vite që luftonin kundër pushtuesve dhe mori pjesë në çlirimin e qyteteve, si Gjirokastra, Berati, Tirana etj.

Brenda tre mujsh nga krijimi Brigada arriti të kishte një efektiv prej 820 partizanë e partizane. "Partizanët e Brigadës së VIII-të Sulmuese, bij të thjeshtë të trevave atdhetare dhe patriotike të jugut, shkruan me gjakun e

tyre histori lavdie gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Pas çlirimit të Tiranës, Brigada e 8-të S, me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm marshoi së bashku me forcat e Brigadës së 6-të në tokat e ish-Jugosllavisë, në ndjekje të pushtuesit. Gjatë luftimeve të atjeshme ranë heroikisht Heroi i Popullit Thidhori Mastora dhe komisar trim i batalionit të 3-të, Pano Xhixho.

Brigada e 8-të Sulmuese ka lënë në fushën e luftimeve kundër armikut 148 dëshmorë dhe rreth 176 të plagosur, nga këto tre shoqe partizane.

Emrat e dëshmorëve të kësaj brigade, të shokëve dhe shoqeve të armëve, të cilët dhanë jetën për atdheun në moshën më të bukur, janë shkruar me shkronja të arta në panteonin e kombit shqiptar.

Veteranët e LANÇ dhe paardhësitë tyre janë krenarë për gjakun, mundin dhe sakrificat e partizanëve dhe dëshmorëve e heronjve të kësaj Brigade.

Në këtë përvjetor të shënuar të saj, për historinë e popullit shqiptar, shprehim bindjen dhe besimin e palëkundur se ëndrrat, idealet dhe gjaku i 28 mijë dëshmorëve do të respektohen ndër breza.

## VLERESIMI

*Federata e Paqes Universale Shqipëri, vlerëson me titull nderi kryetaren e OBVLP*

# TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU

## “AMBASADORE PËR PAQE”

• “Në botë numërohen mbi 150 mijë ambasadorë të paqes. Unë ndihem krenare që po i bashkohem më shumë se 1000 ambasadorëve të paqes në Shqipëri e Kosovë që kontribuojnë në sferën akademike, fetare, në shoqërinë civile etj”, tha ndër të tjera kryetarja e OBVLP-së.

**K**ryetarja e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve, Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, më 7 Mars të këtij viti përfundoi gëzim të dyfishtë. Si ish-mësuese e lëndëve Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë Italiane, Gjuhë Ruse dhe Frënge për 26 vite, mori dhjetra urime për festën e 7 Marsit, ndërsa u vlerësua nga Federata e Paqes Universale Shqipëri me titullin “AMBASADORE PËR PAQE”.

Në ceremoninë festive të organizuar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, nga Federata Shqiptare e Grave për Paqe, në bashkëpunim me Komisionin e Grave për Paqe pranë Federatës së Paqes Universale dhe Këshillit të Paqes Tiranë, në sallën “Alfred Moisiu” të Ambasadës së Paqes ku u zhvillua veprimtaria me temë “PËR TË GJITHA GRATË & VAJZAT – TË DREJTA, BARAZI, FUQIZIM” dhe ku morën pjesë rreth 130 zonja të nderuara Ambasadore për Paqe dhe të ftuar të veçantë, Tatjana qe e para që u vlerësua me këtë titull.

Jo rastësisht për ta lauruar me këtë titull ishte përzgjedhur Znj. Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare me gradën madhore gjeneralmajor. Ndër të tjera ajo do të shprehej se Tatjana Parllaku Çarkaxhiu e ka meritur këtë titull gjatë gjithë karrierës së saj, duke shfaqur dukshëm inteligjencën e rrallë dhe shpirtin e saj human.

Tatjana Parllaku Çarkaxhiu, vajza e gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe “Nderi i kombit”, krenare për veprën e lavdishme të të jaitit, premtan se ashtu si Ai, do ta përm-bushë me përkushtim të rrallë misionin e ambasadores për paqe.

Përpara zhvillimit të ceremonisë së vlerësimit të 10 zonjave të nderuara të përzgjedhura me shumë kujdes nga organizatorët, me titullin “Ambasador për Paqe”, znj. Manjola Vasmatics prezantoi parimet universale të paqes dhe domethënien e titullit “Ambasador për Paqe”. Më pas, mes emocioneve dhe duartrokitjeve pafund, 10 zonjat e nderuara të cilat u vlerësuan me titullin “Ambasador për Paqe”, që vinin nga fusha të ndryshme si arsimit, gazetaria, shoqëria civile, turizmi, krijimtaria letrare etj, ishin: Znj. Tatjana Parllaku Çarkaxhiu; Znj. Jonida Shehu; Prof. Asoc. Dr. Rudina Rama; Znj. Oltjana Shehaj; Znj. Lela Dardha Kokona; Znj. Floresha Baba; Znj. Esmeralda Mema; Znj. Miranda Bala; Znj. Orjana Çekrezi; dhe Znj. Lili Doda.

### TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU, KRENARE PËR MISIONIN FISNIK TË AMBASADORES PËR PAQE

Në fjalën e saj, Znj. Parllaku Çarkaxhiu shprehu kënaqësi të veçantë që ndodhej në Ambasadën e Paqes Universale, të cilën Presidenti Moisiu me të



## KUSH ËSHTË TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU

**Ka mbaruar studimet në degën e Gjuhë Letërsisë, në Fakultetin e Histori Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, në vitin 1975.**

**Ka dhënë mësim në lëndët Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë Italiane, Gjuhë Ruse dhe Frënge. Ka monitoruar reformën zgjedhore në Shkollat e Larta dhe Universitete, si dhe gjatë gjithë karrierës të gjatë në arsim ka edukuar brezat e rinj me kurajon, vetëbesimin dhe dashurinë për dijen, duke i inkurajuar në zhvillimin e tyre të mëtejshëm intelektual.**

**Me moton: “Mësuesit janë ata që krijojnë dhe frymëzojnë ëndrrat dhe mendjet e së ardhmes”, ka ushtruar profesionin e mësuesit me pasion e përkushtim për 26 vite rresht.**

**Ka punuar për më shumë se 10 vjet si Ndihmëse për arsimin, kulturën, shëndetësinë dhe shkencën, pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Ka qenë pjesë e Grupit të Punës në mbrojtje të Monumenteve të Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar në përfshirjen e qyteteve të Gjirokastrës dhe të Beratit në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.**

**Është aktiviste në mbrojtje të të drejtave të të përndjekurve politikë, fëmijëve, grave, moshës së tretë dhe shtresave në nevojë. Jam Kryetare e Kryesisë së Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare.**

**Është dekoruar me Medaljen e Mirënjohjes, dhënë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Dekret Nr. 5429. Datë 23.07.2007 “Në shenjë mirënjohjeje për ndihmesën e dhënë në realizimin me sukses të detyrave të Institucionit të Presidentit të Republikës”.**

drejtë e ka cilësuar si një aset të çmuar për Kryeqytetin.

“Kjo Ambasadë është qendër e aktiviteteve të paqes në Shqipëri, Ballkan dhe më gjërë për të promovuar vlerat e familjes, leadershipin, qeverisjen e mirë, edukimin dhe trajnimin e të rinjve me vlerat e dashurisë për dijen, njerëzit dhe kombin.

Ballkani ka kaluar sfida të jashtëzakonshme dhe luftëra për përgjakshme dhe është koha për reflektim. Feder-

ata e Paqes Universale është një rrjet global individësh dhe organizatash që janë përkushtuar ndërtimin të një bote në paqe, bazuar në vlera morale dhe shpirtërore universale.

Në botë numërohen mbi 150 mijë ambasadorë të paqes. Unë ndihem krenare që po i bashkohem më shumë se 10000 ambasadorëve të paqes në Shqipëri e Kosovë që kontribuojnë në sferën akademike, fetare, në shoqërinë civile etj”, tha ndër të tjera kryetarja e

OBVLP-së.

Si pasardhëse veterani dhe Kryetare e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës dhe pasardhësve të tyre (OBVLP) ajo theksoi se nuk është ofiqi që e bën njeriun të dobishëm por është zemra dhe pasioni që e mbajnë atë me energji dhe kontribute.

“Në tre dekada aktivitete intensive OBVLP u dëshmuara para shqiptarëve si Organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon fort krimet e komunizmit, u bë mbështetje e luftës së UÇK-së dhe në tërësi mbështetëse e çështjes mbarëkombëtare shqiptare. Me punën e më shumë se 10 mijë veteranëve dhe pasardhësve të tyre që militojnë aktualisht në organizatë, ne kontribuojmë në të mirë të demokracisë, drejtësisë dhe të ardhmes së brezave të rinj. Ne mbrojmë traditat luftarake dhe vlerat patriotike të të parëve tanë, dhe në prag të këtij 8 Marsi, unë përkulem me respekt përpara grave themeluese të OBVLP-së të cilat janë mentore dhe inkurajim për ne si dhe shëmbull për të vazhduar sot misionin fisnik të ambasadorit për paqe”, tha më tej Znj. Parllaku Çarkaxhiu. Ajo solli në vëmendjen e qindra të pranishmëve ambasadorë për paqe, zonjat e nderuara Selfixhe Broja Ciu, Zenepe Golemi Ashiku, Liri Belishova, Vera Ngjela Pojani, që në lulen e rinisë u bënë pjesë e Luftës Antifashiste, të cilat të dënuara nga sistemi diktatorial, nuk u thyen por luftuan fuqishëm për triumfin e demokracisë në Shqipëri dhe për aderimin e Shqipërisë në NATO.

“Ne pasueset e tyre premtojmë se do të mbrojmë traditat luftarake dhe vlerat patriotike të të parëve tanë dhe do të punojmë fort për integrimin e Shqipërisë (Vijon në faqen 16)

## 106 – VJETORI I LINDJES

Gjenerali legjendar, Hero i tri epokave ka vetëm ditëlindje

## Rrahman Parllaku, gjenerali që sfidoi kohërat

Nga Halil Rama

Gjenerali i tri epokave, Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, lindi, u rrit dhe mbeti patriot. Lufta Antifashiste, mbrojtja e vendit gjatë periudhës së luftës së ftohtë, “lufta e bërrylave”, ftohtësia e qelive të burgut ku kaloi rreth 17 vjet, Lufta e Kosovës më 1999, krijimtaria publicistike dhe aktiviteti intensiv në mbështetje të proceseve demokratike e të shtetit ligjor, e forcuan karakterin e tij.

Jeta e këtij gjenerali që është memoria historike e kombit nis në Novosë të Kukësit, kur më 17 prill 1919 lindi një djalë që u quajt Rrahman Latif Parllaku. Me ato që bëri gjatë jetës, me zgjuarsinë dhe guximin e tij, duket sikur trashëgoi cilësitë e Ali Matës, një paraardhës shumë i pashëm nga ai fis, të cilin turqit e kërkonin me llagapin “Parllak”, që në turqisht do të thotë “i ndritshëm”.

Pas shkollës fillore që e kreu në Shishtavec, Rrahman Parllaku detyrohet ta lërë fshatin dhe të fillojë punë me babanë dhe vëllanë në profesionin e pastičerit në Cakran të Mallakastrës, e më pas në Selenicë të Vlorës, ku u njoh me mjerimin dhe shtypjen e egër që u bëhej punëtorëve të minierës së bitumit.

Pushtimi i vendit nga Italia fashiste dhe shpirti patriotik i vlonjatëve që e kishin ende të freskët Epopenë e lavdishme të 1920-ës, si dhe plagët e gjakosura të Kosovës martire të shpëputur nga trupi i Shqipërisë mëmë, kalitën tek djaloshi lumjan ndjenjën e revoltës dhe dëshirën për liri.

Ëmbëltoja “Selim Parllaku”, ose ëmbëltoja “Kosova”, u bë qendër e organizimit të rezistencës antifashiste në Vlorë dhe “Krajli”, siç e kishite pseudonimin Rrahmani, punonte në lokal, pa dyshuar askush se merrej me veprimtari guerile.

Që nga marsi 1942 e deri në dhjetor 1943 “Krajli” ishte një nga udhëheqësit e njësitëve guerile të qytetit të Vlorës. Më pas ai doli në mal, sepse kontributi i tij kërkohet në ballë të betejave për çlirim, ku u ngarkua me detyra të rëndësishme, të cilat i kreu me sukses. Nis kështu rrugëtimi i gjatë i tij nëpër male e pyje, nga njëra zonë në tjetrën, nga Shqipëria e Jugut në Shqipërinë e Mesme e atë të Veriut, madje deri tutje për çlirimin e trojeve të vëllezërve kosovarë. Nga njëra betejë në tjetrën, në luftë e përpjekje të vazhdueshme përballë një armiku të egër, por edhe kushteve të vështira të terrenit e të motit të ashpër, ai u kalit si një luftëtar e drejtues i zoti.

“Luftë civile me pushtuesin brenda nuk mund të ketë”

Gjenerali që luftoi fashizmin dhe sfidoi komunizmin, Hero i Popullit dhe një prej figurave më qendrore dhe emblematike të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, në librin e tij testament MEMORIA HISTORIKE E KOMBIT”, poshtë tezat antishqiptare të një të ashtuquajturë “Luftë Civile”. Duke evidencuar vlerat e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të popullit shqiptar, luftë e lavdishme kjo që e radhiti Shqipërinë përkrah forcave aleate në Luftën e Dytë Botërore, Anglisë SHBA-së dhe ish Bashkimit Sovjetik, gjenerali Parllaku shkruan se kurrsesi nuk mund të ketë “Luftë Civile” në një vend të pushtuar nga të huajt, siç ishin fashistët italianë dhe nazistët gjermanë. Gjenerali ka shkruan në këtë lojë lojë të historisë kombëtare dhe ndjejmë emocione. Prandaj e vlerësojmë shumë gjykimin e tij, nëse duhet quajtur lufta si një faqe lavdie e historisë së popullit tonë, apo një luftë civile. “Luftë civile me pushtuesin brenda nuk mund të ketë... Në luftuam kundër pushtuesve nazifashistë duke u bërë pjesë e bllokut



antifashist të popujve të botës”, shkruan gjenerali shekullor.

Pas çlirimit të vendit nga pushtuesit e huaj, në sajë të punës së palodhur dhe aftësive të tij, Gjenerali Parllaku arriti të bëhet një nga drejtuesit e lartë të ushtrisë sonë.

Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë ai u ndesh me skenarët pro jugosllavë për bashkimin e shtetit dhe të ushtrisë shqiptare me Jugosllavinë dhe luftoi për shkatërrimin e tyre.

Me të njëjtën vendosmëri ai luftoi edhe pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, kur ushtarakët dhe udhëheqja sovjetike u përpoqën t’ja rrëmbenin Shqipërisë nënndetëset nga Baza e Pashalimanit... Por Pashalimani dhe Gjiri i Vlorës ishin kafshata që nuk kapërdiheshin aq lehtë, sepse mbroheshin nga djem nënash të drejtuar me mençuri e guxim nga ushtarakët të zotë, mes të cilëve ishte edhe Gjenerali Parllaku.

Fitimtari i tri kohëve

Gjenerali Rrahman Parllaku sa që gjallë, me mendje të freskët e memorie për t’u patur zili u dëshmoi shqiptarëve histori të tre kohëve, të partizanit e luftëtarit antifashist, heroit e komandantit ushtarak dhe atë të persekutimit komunist.

Pas 30 vjetësh shërbimi të përkushtuar si ushtarak, ky gjenerali i famshëm i Luftës nacional-çlirimtare dhe i ushtrisë shqiptare, do të shpërblehej nga regjimi i E. Hoxhës me 25 vjet burg, si pjesëtar i të ashtuquajturit “Grupi Puçist i Ushtrisë”, së bashku me Beqir Ballukun, Petrit Dumen e Hito Çakon, që u dënuan me pushkatim. Por Gjenerali nuk u ligështua nga balta e pisët, me të cilën deshën ta damkosnin si tradhëtar. Si arriti të mbijetojë në ato kushte ku kaloi 17 vjet të jetës së tij.

Dhe pas daljes nga burgu më 1991, nuk u pajtua me amnistinë e Ramiz Alisë, por ndoqi procedurat gjyqësore për të fituar pajfësinë. Në rekursin e bërë nga Parllaku, Gjykata e Kasacionit vendosi, më 20 korrik të vitit 1994, prishjen e vendimit të 5 nëntorit të vitit 1975 të Gjykatës Ushtrake, që e cilësoi atë fajtor dhe pushimin e akuzave të mësipërme.

Gjenerali Parllaku, që nga vitit 1998 e deri sa ndërroi jetë më 15 shtator 2019 e drejtoi me përkushtim organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it, duke e bërë atë deri anëtar të denjë të Federatave Botërore e Europiane të Veteranëve.

Ai ia doli mbi të gjitha furtunat e jetës, doli fitimtar nga lufta antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe sot është gjenerali më i vjetër, por me mendje të re që mbështeti anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO. “Simbol i qytetit të Tiranës”

Gjashtë vjet më parë, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës ka nderuar gjenerali Rrahman Parllakun me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës”, një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste.

Gjenerali Rrahman Parllaku që ndër të paktët drejtues të LANÇ-it e të Ushtrisë Shqiptare që jetoi një shekull duke dëshmuar histori të tri kohëve, të partizanit e luftëtarit antifashist, heroit e komandantit ushtarak dhe atë të persekutimit komunist. Ai ishte dhe mbeti simboli i njerëzve që pavarë-



sisht sakrificave, ka dhuruar vetëm dashuri dhe mirësi.

Bashkëluftëtarët, bashkëkohësi dhe pasardhësit e tij ndjehen krenarë, për gjithëçka Ai ka bërë në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar.

Me Gjenerali Parllakun ndihen krenarë të gjithë miqtë e shokët e tij. Ndihen krenarë familjarët e tij, që e kishin përmendore të gjallë të traditës dhe të virtutit të tyre familjar të trashëguar ndër shekuj.

Emri dhe veprimtaria e Gjeneral Parllakut është bërë e njohur nëpërmjet angazhimeve të ndryshme ku ai ka qenë i pranishëm vazhdimisht.

Gjithashtu, publiku ka mirëpritur edhe librat e ndryshëm të shkruar nga Gjenerali, siç është ai me titull: “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”, “Kosova, ëndrra e jetës sime”, dhe libri me shtatë kapituj në 466 faqe “Një shekull në memorie”, të cilit po i

Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjempërthetësi të madhe, gjenerali Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi dhe ushtria jonë. E veçanta e gjithë “ligjëratave” të tij në shtypin e kohës dhe në veprimtari promovuese të librave kushtuar Luftës Nacional-Çlirimtare e heronjve të saj, ka qenë gjykimi i tij tepër i saktë, konçiz, realist, pa mllëfe, pa paragjykim... Ai e ka vlerësuar gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit në tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë... si dhe këto vite të demokracisë e pluralizmit.

Përveçse me dekoratën e lartë “Nderi i kombit”, gjenerali Parllaku është nderuar me Medalje, Mirënjohje e titullin “Qytetar Nderi”, nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë, z. Aldrin Dalipi, nga Këshilli i Qarkut Kukës, ndërkohë është pritur me madhësi dhe nderuar si fitimtar i tri kohëve nga bashkëluftëtarët e bashkëkombas në Gjakovë e Prizren, por edhe me Malin e Zi, Kroaci e Beograd...

Kjo për faktin se Gjenerali Rrahman Parllaku ia doli mbi të gjitha furtunat e jetës. Doli fitimtar nga Lufta Antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe sot është gjenerali më i vjetër, por me mendje të re që mbështeti anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO. Nga jeta e këtij Matuzalemi na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t’u ndjekur... Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut si veteran në këtë çerek shekull të demokracisë mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Jeta dhe vepra e tij e veshi atë me pavdekësi....



## 100 VJETORI

Me rastin e 100 vjetorit të vrasjes së Heroit të Popullit, Bajram Curri... Varrimi i tij javën e parë të prillit të 1925-s

# “O Bajram - Bajrak i gjallë”

Figura përmasore e Heroit të Popullit Bajram Curri mbetet ndër breza një simbol i përpjekjeve të pakursyera në shërbim të Çlirimit e Bashkimit Kombëtar

Nga, Gëzim Prengzi

**H**ero i Popullit Bajram Curri lindi në Gjakovë. Të parët e tij u shquan si luftëtarë në kryengritjet antiosmane. Bajram Curri u shqua si veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të Rilindjes, duke qenë një ndër udhëheqësit politikë e ushtarakë të kryengritjeve popullore kundër osmane dhe të luftës për çlirim e bashkim kombëtar të vendit...

Konflikti midis dy familjeve të mëdha gjakovare “Curri” e “Kryeziu” i ka fillesat herët kur këto synonin kreun e Gjakovës. Ky konflikt megjithëse herë fshihej e herë shfaqej, mbeti i gjallë. Kryezinjët ose Riza beg Kryeziu ishin të kamur e gëzonin privilegje të mëdha, ndërsa familja “Curri” nuk kishin pasuri as nuk ishin bajraktarë por gëzonin reputacion si familje atdhedashëse. “Lidhja e Pejës” 1899-1900 u përgatit dhe u organizua nga Haxhi Zeka e B. Curri, të cilët hasën në kundërshtinë e fortë të Riza Kryeziut, i cili mbajti qëndrime negative deri në Kuvendin e Junikut. B. Curri merr pjesë si drejtues në kryengritjet e viteve 1908-1912 kur mbërrin fitimtar në Shkup bashkë me Hasan Prishtinën. Shpallja e Pavarësisë e gëzoi pa masë, por vendimet e padrejta të Konferencës së Londrës 1913 që lanë jashtë kufirit të shtetit amë Kosovën e viset e tjera e obligojnë më shumë për çështjen kombëtare.

Më 1913 Bajram Curri njihet me një djalë 18 vjeçar, Ahmet Zogun, dhe më 1914 të dy do ishin në mbrojtje të Princ Vidit. Pas një plagosjeje me atentat nga Ceno begi, Bajram Curri arratiset për disa vite në Vjenë por pa u shkëputur nga çështja kombëtare.

Më 1 maj 1918, në Shkodër formohet Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, kryetar ishte Hoxha Kadri Prishtina dhe Bajram Curri do të ishte nga anëtarët më aktivë të saj. Ky Komitet në vitet 1920,



Në foto: Bashkëshortja e B. Currit, Der-vishe Curri; Bekim Fehmiu, Hajrie Curri, Ragip Meta, Mimoza Meta, Rasim Kraja, Valdete Duraku, Perparim Duraku - foto e vitit 1972



21, 22, 23 u përpoq të organizojë kryengritje për çlirimin e Kosovës dhe kishin prioritet bashkimin e saj me shtetin amë, por Ahmet Zogu nuk i përkrahu.

Më 1920 Qeveria e kryesuar nga S. Delvina e fton B. Currin në postin e min. pa portofol, ndërsa A. Zogu ministër i brendshëm. Deri këtu nuk kishte gjurmë konfliktesh mes tyre. Dhjetori i vitit 1923 ndërron 4 qeveri në një muaj, ajo me kryemin. Xhafer Ypin e emëron A. Zogun ministrit të brendshëm. B. Curri e kundërshton këtë zgjedhje duke u kthyer në një nga kundërshtarët më të ashpër të saj dhe synonte rrëzimin e saj.

Organizimi i një kryengritjeje për rrëzimin e qeverisë nga B. Curri e Elez Isufi në mars 1922 nuk arriti sinonimin, pasi vetëm E. Isufi hyri në Tiranë. Situatën e qetësoi ambasadori britanik me ndërhyrjen e tij. Konflikti mes B. Currit e A. Zogut mori përmasa aq sa me insistimin e Zogut, i hiqen gradat, nxirret jashtë ligjit dhe dënohet me vdekje B. Curri.

Më 1922, A. Zogu fejon motrën e tij Nafijen me Ceno beg Kryeziun, ky moment nuk mund të kalojë pa lënë gjurmë, pasi ky kishte lidhje të forta me Beogradin, kjo i vinte përshtat edhe A. Zogut për të shuar lëvizjet e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” ku B. Curri kishte ndikim të fortë.

Vrasja e A. Rustemit dhe Revolucionit i nisur nga B. Curri në Malësinë e Gjakovës duke mbërritur në Tiranë, rrëzon Qeverinë e Zogut që arratiset jashtë shtetit. Në qeverinë e Nolit B. Curri nuk mori asnjë post zyrtar por pranoi të dalë në pension, te paktën kështu u tha... megjithatë B. Currin në gusht e shohim me L. Gurakuqin në Vjenë në Lidhjen e Kombeve. Ndërkohë A. Zogu i ndihmuar nga Serbia e Pashiqit po përgatitej të hynte në Shqipëri. Me 10 dhjetor i shoqëruar me forca të shumta bjellogardiste të armatosura e që paguheshin me napolona ari pas një qëndrese të fortë në Peshkopi nga forcat e E. Isufit, i cili plagoset dhe vdes nga plagët, A. Zogu hyn në Tirane. Fan Noli dhe përkrahësit e tij largohen jashtë shtetit, përveç B. Currit, i cili qëndron në Shqipëri për të nisur duelin historik.

Në fillim të vitit 1925 A. Zogu emëron kunatin e tij Ceno Begun si komandant Operacioni për Veriun për të eliminuar kundërshtarët e tij. U ngrit një strukturë e posaçme për të eliminuar kundërshtarët, si të arratisurit jashtë por edhe brenda.



Në funksion të kësaj u hap edhe një fond i quajtur “FONDI I HJEKSAVE” për të bërë vrasje enigmatike por edhe të drejtpërdrejta. A. Zogu i bëri thirrje B. Currit të dorëzohej e të hiqte dorë nga çështja kombëtare duke i premtuar pension të madh e shuma parash, por ai këmbëngul për të mos u dorëzuar.

Duke qenë një figurë me reputacion në Kosovë e Malësinë e Gjakovës, B. Curri u ndoq ngado, pasi duhej të shuhej “Komiteti Mbrojtja e Kosovës”. Në këto kushte B. Curri ne mars 1925 shkon në Shpellën e Dragobisë. Më 29 mars forca të shumta xhandarësh e rrethojnë duke e vrarë/vetëvrarë (ekzistojnë dy versionet), po ç’rëndësi ka kjo.

Atë e vrau A. Zogu... dhe po vetë ky organizon varrimin e B. Currit ne Krumë në fillim të prillit ku prefekt ishte Hasan Kryeziu, i vëllai i kunatit të A. Zogut, Ceno Begut, komandantit të operacionit për vrasjen e tij (shih qëndrimin e Hasanit te kryet e B. Currit, fotoja flet vetë). Në varrimin e tij morën pjesë rreth 2000 vetë. Por më pas u shtruan konaqe e “ia pinë sherbetin” me paret që u dhanë për vrasjen e



Në foto: Kolonel Ali Demushi, me vajzën e B. Currit, Hajrie Curri

tij.

Me 1926 A. Zogu bën një kthese 360 gradë, zgjedh Italinë si aleatë... kjo i shkakton konfliktualitet me kunatin e tij Ceno Begun, i cili ishte ihtar i Beogradit zyrtar. Shkëmbejnë replika të forta mes tyre aq sa Zogu e këshillon të mbyllë gojën, gjithsesi pa rezultat, por ia gjeti çelësin. Ceno beg Kryeziun e dërgoi atje ku ai ndihej rehat, ambasador në Beograd, ku vritet me atentat nga një i ri elbasanas në Evropë, i cili dinte 4 gjuhë të huaja. Ky i fundit në sallën e gjyqit shpjegoi vetëm se ishte pjesë e një organizate, por pa e cilësuar atë, dhe kjo mbeti enigmë pasi edhe ky u vra në sallën e gjyqit nga truproja e Kryeziut!

Figura përmasore e Heroit të Popullit Bajram Curri mbetet ndër breza një simbol i përpjekjeve të pakursyera në shërbim të Çlirimit e Bashkimit Kombëtar.

80-VJETORI

# KRENAR NË 80 VJETORIN E LAVDISHËM TË SHKOLLËS USHTARAKE “SKËNDERBEJ”

SHPENDI TOPOLLAJ

Nënkryetar i Parë i shoqatës  
Kombëtare “Skënderbegasi”,  
“Nderi i Kombit”

Tani, në 80 vjetorin e krijimit të saj, asnjëri nuk është i sigurt se kush ia shtiu ndërmend udhëheqjes së sapodalë nga lufta Nacional çlirimtare që për doshshmërinë e forcimit të një ushtrie moderne, të krijonte shkollën e pionierëve të luftës (e njohur si shkolla e kadetëve), më 28 mars të vitit 1945, kryesisht me djem që ende nuk e kishin lëshuar armën nga dora. Po ashtu, nuk dihet mirë se kush u kujtua pak më pas, pra më 11 shkurt të vitit 1947, ta quajë atë shkollë ushtarake “Skënderbej” dhe vetë nxënësit që mësonin atje, skënderbegas. E sigurt, pas kaq e kaq vitesh është se ajo ka qenë një nga punët më të zgjuara të asaj periudhe, pasi ajo shkollë, duke u vënë në krye të gjerdanit të artë të ushtrisë tonë të re, e përlligji besimin, kujdesin, vëmendjen dhe shpenzimet që u bënë nga populli ende shumë i varfër, duke u rreshtuar pa asnjë mëdyshje edhe në pararojë të historisë së lavdishme të arsimit shqiptar. Me kalimin e viteve dhe vështirësive të panumërta, ajo erdhi duke u forcuar e konsoliduar si nga ana ekonomike, baza materiale dhe ajo didaktike, perfeksionimi i taktit pedagogjik të oficerëve komandues e personelit mësimdhënës, përzgjedhja e atyre që do të studionin atje, pra krijimit të kushteve të një shkolle moderne, por edhe në kalimin e saj në një shkollë të mesme të arsimit të përgjithshëm, me programet e miratuara nga e njëjta ministri Arsimit si të gjitha simotrat e saj. Fjala “ushtarake” që shpesh konfondohet, ka një konotacion krejt tjetër nga ai që përfytyrohet, pasi ajo përveç uniformës, rregullit e disiplinës dhe kontigjentit që përgatiste për t'i çuar në të ardhmen kryesisht në shkollat ushtarake brenda dhe jashtë vendit, ku do të aftësoheshin si oficerë që do të merrnin në dorë drejtimin, modernizimin dhe komandimin e repartëve të ndryshme të të gjitha llojeve dhe armëve, në asgjë nuk dallonte nga ato të arsimit të përgjithshëm. Natyrisht, që kishte dhe disa avantazhe të tjera, si studimi i organizuar, serioz dhe i kontrolluar mbasditeve, mundësia e kalitjes fizike, marrja me të gjitha llojet e sportit nën mbikqyrjen e trajnierëve dhe mësuesve tejet të kualifikuar, plot pasion e përvojë, e kombinuar me edukimin atdhetar, qytetar dhe kulturor. Libri artistik që kalonte dorë më dorë, u bë për skënderbegasit i shenjtë. Aty mësuam jo vetëm jetën dhe bëmat e kapedanëve të mëdhenj, ku pa tjetër hynte edhe Heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti, por edhe autorët më në zë të botës, për të mos thënë se i mësuam përmendësh krijimet më të arrira të poetëve genialë. Kjo është dhe arsyeja, përse miqtë më të mirë dhe më të dashur të skënderbegasve ishin sportistët, artistët dhe shkrimtarët. Dhe vetëm këtu e gjen shpjegimin fakti që nga dyert e kësaj shkolle, përveç



oficerëve të kulturuar e gjeneralëve të zot në të gjitha llojet e armëve, dolën një pafundësi poetësh, prozatorësh, dramaturgësh, këngëtarësh, valltarësh, shkencëtarësh, mjekësh, inxhinierësh dhe sportistësh elitare, shumë prej të cilëve janë laureuar me tituj të ndryshëm dhe bëjnë pjesë të lavdia dhe krenaria e Shqipërisë. Me këtë shkollë janë të lidhur shumë nga emrat e kthyer tashmë në legjendë të cilët gjithë jetën shprehën respektin dhe dashurinë më të madhe për skënderbegasit dhe dhanë vlerësime nga më të lartat për atë shkollë. Dhe kishin plotësisht të drejtë, pasi nxënësit e asaj shkolle edhe kur u caktuan në detyra të ndryshme anë e kënd Atdheut si kuadro të të gjitha rangjeve në të gjitha llojet e armëve, u dalluan për vlera të padiskutueshme njerëzore, besnikëri e atdhetari, edukatë e thjeshtësi në marrëdhëniet me të tjerët, dashuri për shokët, shpirt të madh sakrifice, këmbëngulje në realizimin e detyrave, vullnet në kapërcimin e vështirësive, trimëri e qartësi kur e lypnin interesat e Shqipërisë. Kur ndryshimet e domosdoshme politike sollën suprimimin e shkollës tonë,

gjë që ndodhi pas vendimit Nr. 3 dt. 14.08.1992 dhe lëshimit të urdhërit Nr. 159 dt. 25.08.1992 të Ministrisë të Mbrojtjes, natyrisht që u hidhëruam. Ndiheshim bijtë e saj. Ne kishim shumë e shumë kujtime e mirënjohje për të, ndaj dhe e përjetuam keq atë mbyllje. E dinim fare mirë kontributin që ajo kishte dhënë, pasi prej saj dolën mijra e mijra kuadro besnike të atdheut, nga të cilët mbi njëqind mbanin tituj të lartë shkencor dhe përsëri mbi njëqind, u bënë Mjeshtra dhe Mjeshtra të Mëdhenj Sporti që i dhanë emër Shqipërisë edhe në arenat ndërkombëtare. Mjaft të kujtojmë se prej saj, krahas disa Ministrave e zëvendësministrave të Mbrojtjes dhe shumë e shumë komandantëve e komisarëve të Korpuseve, Divizioneve apo Brigadave, dhe Drejtorëve të Drejtorive në atë ministri, kanë dalë disa Shefa të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë si Sami Meçollari, Ilia Vasho, Kostaq Karoli, Adem Çopani, Halim Abazi, Pëllumb Qazimi, Maksim Malaj, Jeronim Baze, Xhemal Gjumshi, Bardhyl Kollçaku, Arben Kinxhi. Prandaj, kjo nostalgji për të ishte e kuptueshme dhe tërësisht njerëzore. Pastaj, ne as që i mendonim

kuadrot e ushtrisë pa kaluar në bangat e kësaj shkolle. Mirëpo, hapja e domosdoshme e jona drejt Evropës, politikat e reja të mbrojtjes dhe futja e Shqipërisë në NATO, sofistikimi i armatimeve e teknikës dhe mënyrave të luftimit si dhe krijimi i një strategjike të re në pajtim me synimet e aleatëve perëndimorë me në krye SHBA- në, morën rrjedhë tjetër. Efektivat e ushtrisë, të reduktuara në maksimum, mundet që e bënë të pa nevojshme mbajtjen e asaj shkolle, madje edhe të shkollave të oficerëve dhe akademinë ushtarake. Në këto kushte s'na mbetej tjetër, veçse shoqatës “Skënderbegasi” që kishim krijuar, t'i jepnim karakter komemorativ. Pra të mbledheshim, të evokonim ngjarje dhe personalitete të shquara që kishin lidhje me atë shkollë, të çmалleshim me njëri-tjetrin dhe të mos harronim kurrë se atje u mbrujtëm me virtytet më të mira dhe morëm mësimet themelore për t'i shërbyer Atdheut me nder. Dhe sidomos, edukimin e anëtarëve me mendimin e ri se interesat e atdheut tonë, tani ishin orientuar drejtë dhe jo të kushtëzuara nga ideologjitë e dështuara aventureske dhe vasaliteti. Fundja, kështu edhe kthenim në një fare mënyrë detyrimin që kishim ndaj vendit dhe asaj shkolle. Mjaft të përmend faktin se Shtatmadhorinë e Ushtrisë shqiptare sot dhe shumë nga formacionet e saj me mision jashtë vendit, i drejtojnë me sukses të plotë ish skënderbegasit e dikurshëm. Kush i ndjek nga afër këto veprimtari, sidomos ato të 28 Marsit, ditës së krijimit të shkollës tonë, duke parë pjesëmarrjen e pashembullt, entuziazmin e paplakur të ish nxënësve të saj, sytë e qeshur të atyre burrave tashmë të moshuar që shkëlqejnë me një ndriçim rinor dhe besim në të ardhmen demokratike të popullit tonë të vuajtur, dashurinë e pashuar për njëri-tjetrin dhe krenarinë që ende quhen skënderbegas, bindesh se ajo shkollë nxorri bijtë më të mirë të Atdheut tonë. Dhe duhet theksuar se një rol të jashtëzakonshëm në mbarëvajtjen e kësaj shoqate, ka luajtur ish kryetari energjik, doktori i shkencave Mikado Shakohoxha i cili me mençurinë, urtësinë dhe modestinë e tij, tashmë e drejtuar nga zotërinjtë Dhanil Reveli e Rifat Marsela, ka bërë që kjo shoqatë të ruajë të paprekur reputacionin që me të drejtë gëzon dhe të cilës Presidenti i Republikës i ka akorduar titullin e lartë “Nderi i Kombit”. Nga ana tjetër, ne gjithmonë kemi ngritur zërin mbi domosdoshmërinë e forcimit të ushtrisë tonë, si garancia më e madhe dhe më e sigurtë e mbrojtjes së Atdheut në çdo rrethanë a situatë që mund të krijohet. Ne skënderbegasit vimë në këtë 80 vjetor me kokën lart para Atdheut, pasi gjithmonë i kemi shërbyer dhe jemi gati t'i shërbejmë me besnikëri vendit e popullit tonë, ashtu si të parët tanë brez pas brezi, dhe për ta letrarizuar po kujtoj; ashtu siç thosh Pushkini te “Çadajevi”, dhe që gjithë kënaqësi e deklamonim dikur korridoreve të shkollës tonë: Gjersa me nder të rrojmë mbi dhe / E për liri ne të luftojmë / O miku im veç për Atdhe / Çdo çast ne duhet të mendojmë.

## 80-VJETORI

Gjeneralletenant Arben Kingji: Themel i rëndësishëm në formimin profesional të brezave pas Luftës së Dytë Botërore



# Ministri Vengu: Shkolla “Skënderbej”, vatër e edukimit të brezave

*“Emri Skënderbegas, ende reflekton peshën historike në radhët e Forcave tona të Armatosura. Skënderbegasit apo Beksat, siç ju e përdorni, u shquan dhe shquhen si shembull i përkushtimit, nderit, disiplinës dhe atdhetarisë”, -tha ndër të tjera Ministri Vengu*

Emre, 28 mars 2025 -80-vjetori i themelimit të ish-Shkollës së Mesme Ushtarake “Skën-derbej” mbledhi në një aktivitet ish-nxënës, pedagogë dhe drejtues të ish-Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”, por edhe oficerë dhe përfaqësues të Forcave të Armatosura. Të pranishëm ishin edhe ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu, zëvendësministri i Mbrojtjes Enkelejd Joti, deputetë të Kuvendit dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjener-allejtënant Arben Kingji....

Aktiviteti nisi me një interpretim emocionues të himnit kombëtar nga kuarteti i harqeve dhe këngëtarët e orkestrës simfonike të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, ndërsa për të kujtuar kontributin e këtij institucioni në edukimin e brezave u shfaq për të pranishmit, një dokumentar kushtuar historikut të shkollës.

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, nënvizoi vlerat që Shkolla “Skënderbej” ka dhënë për arsimimin ushtarak shqiptar dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura. “Emri Skënderbegas, ende reflekton peshën historike në radhët e Forcave tona të Armatosura. Skënderbegasit apo Beksat, siç ju e përdorni, u shquan dhe shquhen si shembull i përkushtimit, nderit, disiplinës dhe atdhetarisë. Këtë e dëshmon prania juaj sot këtu, punët dhe veprat tuaja ndër dekada. Në këtë kontekst, kjo shkollë mendoj ja ka dalë me krenari të edukojë breza të tërë dhe padyshim si çdo shkollë, ajo lëshon rrënjë të thella edhe nxjerr degë me plot fryte dhe besoj se duhet ta rimarrim patjetër si shembull, shembullin e atyre pedagogëve që me përkushtimin e të cilëve është ndërtuar, jo vetëm një gjeneratë e tërë drejtuesish ushtarakë që sot e kësaj dite vijojnë e mbajnë përgjegjësi shumë të nderuara, por edhe metodat dhe përkushtimin, të cilat duhet t’i rizbulojmë”. - theksoi Ministri Vengu. Ai premtoi që në përv-

jetorin e ardhshëm, të mbledhen në një sallë më të madhe, e cila do të jetë pjesë e kampusit të ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, në Tufinë.

Në fjalën e tij, shefi i Shtabit

al-Çlirimtare (UNÇL) që përkonte me veprimtarinë e njësisë partizane jashtë kufijve të Shqipërisë, komandat partizane porositeshin të kthenin në Shqipëri partizanët e vegjël për t’u shkolluar. Në urdhër

ushtria dhe ti caktojë në shkolla të ndryshme”.

Më 28 mars 1945, në garnizonin e vjetër ushtarak në Laprakë u zgjodhën për herë të parë 200 partizanë të vegjël të moshave 14-16 vjeç, midis tyre dhe 7 vajza, duke krijuar shkollën e parë “të pionierëve të luftës”. Në inagurimin e saj mori pjesë edhe Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL, gjeneral Spiro Moisiu. Vendi sapo kishte dalë nga lufta dhe kushtet për mësim e jetesë ishin të vështira. Si e para shkollë ushtarake, hapja e saj erdhi si rezultat i realizimit të aspiratave madhore të mbare popullit për organizimin dhe zhvillimin e ushtrisë kombëtare menjëherë pas çlirimit të vendit. Ajo ishte e rëndësishme dhe nevojë e ngutshme për shkak të arsimimit të pakët dhe të pamjaftueshëm të një pjesë të luftëtarëve të vegjël partizanë, të cilët ishin të shumtë në radhët e UNÇL, si dhe për hapjen e shkollave të tjera ushtarake në të ardhmen. Ky ishte një objektiv i rëndësishëm

(Vijon në faqen 8)



të Përgjithshëm të FA gjeneralletenant Arben Kingji e cilësoi këtë institucion si një themel të rëndësishëm në formimin profesional të brezave pas Luftës së Dytë Botërore. Nga ana e tij, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, edhe si një ish-nxënës i Shkollës “Skënderbej” theksoi rëndësinë e saj si vatër edukimi dhe formimi të ushtarakëve dhe qytetarëve të përkushtuar për shoqërinë. Po ashtu, ish-komandanti i kësaj shkolle, Mikali Vaso, shprehu mirënjohjen për kontributin e pedagogëve dhe nxënësve të shkollës.

Në këtë ceremoni u shpërndanë certifikata nderi për katër personalitete të shquara të dala nga kjo shkollë.

## LEGJENDA E ARSIMIMIT USHTARAK SHQIPTAR

Projekti për hapjen e shkollës “Skënderbej” i takon shkurtit të vitit 1945.

Me urdhër të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacion-

përcaktohej: “Meqënëse së shpejti çelen shkollat, duke patur parasysh se kjo kategori luftëtarësh partizanë ka nevojë më shumë se kushdo tjetër për arsimim, kjo komandë ka vendosur që t’i heqë nga



## IN MEMORIAM

## YMER PUKA, INTERNACIONALIST I SHQUAR



XHEMAL MEÇI – Mjeshtër i Madh\*

**“Xha Ymeri nuk duhet harruar kurrë”**

**Petro Marko, (Pukë 1981 – Paris 1943)**

**L**indi në një familje të varfër malësore të Pukës, lagjia Kukaj, në janar të vitit 1881. Që në rini ai filloi të shprehte hapur urrejtjen kundër pushtuesve osmanë e sundimtarëve të vendit, duke

përhapur idetë çlirimtare. Kjo veprimtari e tij u bë aq shqetësuese për pushtuesit dhe veglat e tyre vendase, sa morën masa dhe e internuan në Rumeli.

Revolucioni xhonturk i vitit 1908, me programin demokratik dhe antiimperialist e bëri për vete Ymer Pukën, ashtu si shumë atdhetarë të tjerë. I zhgënjyer nga praktika e mëvonshme e xhonturkve, i kthei sytë nga një Revolucion Socialist. I zënë rob nga ushtria ruse në frontin e Kaukazit në vitin e tretë të 1917, të Luftës I Botërore, u internua në një kamp të madh ushtarak në Siberi. Kushtet e rënda të kampit ia forcuan idetë leniniste mbi revolucionin dhe lirinë e popujve. Më 1918 kampi u çlirua prej Ushtrisë së Kuqe. Lenini u drejtoi një thirrje të zjarrtë të gjithë të internuarve të poraçliruar që të mbështesin të vërtetën mbi revolucionin socialist të Tetorit.

Ymer Puka iu përgjegj me entuziazëm kësaj thirrjeje. Duke luftuar me guxim e trimëri shqiptare u gradua kapiten. Mbas dy vjetësh, më 1920, I zhgënjyer nga ky Revolucion dhe kur nga Turqia vinin lajme shqetësuese, vendosi të kthehej aty, në Atdheun e tij të dytë, ku u radhit në forcat revolucionare të Mustafa Qemalit, Atatürkut. Trimëria dhe guximi shqiptar bashkë me idetë leniniste mbi revolucionin e bënë të shquar krah figurave kryesore të revolucionit turk. Por idetë e tij socialiste i kalonin kufijtë e një revolucioni të zakonshëm demokratiko - borgjez. Prandaj borgjezia turke, e trembur nga këto ide, kërkoi që Ymer Puka të largohej nga Turqia. Megjithatë, duke çmuar meritat e tij, Mustafa Qemali porositi ambasadat që sa herë t'u kërkonte ndihmë materiale,

t'ia jepnin. Tani për Ymer Pukën filloi një periudhë endjeje nëpër Evropë. Malli për Atdhe dhe dëshira për të ndihmuar në zhvillimin e përparimin e tij, me gjithë rrezikun që e kërcënonte, e shtyri që të kthehej në Shqipëri. Në Shkodër paraqitet te Marubi, ku bën një fotografi, e cila shënon vitin 1932. Vendlindja e tij e pikëlloi pa masë: Puka me prapambetjen dhe varfërinë e saj legjendare kishte mbetur ashtu si në fund të shek. XIX.

Xhandarmëria e Zogut, që ishte në ndjekje të tij që kur hyri në Shqipëri, pa asnjë bazë juridike e arrestoi më 1936. Mbas 6 muajsh burg në Tiranë, e internoi në Gjirokastrë. Ymeri me përvojën dhe guximin e tij mundi të arratiset jashtë Atdheut në Maqedoni, prej ku me Revolucionarët Maqedonas shkoi në Spanjë.



Jehona e luftës së Republikës Spanjolle kundër fashizmit gjakatar të Frankos, e çoi peshë. Edhe pse 56-vjeçar, të gjitha energjitë e tij i vuri në shërbim të revolucionit spanjoll. Për meritat e tij, trimërinë, guximin dhe aftësitë ushtarake, e graduan major në një nga brigadat ndërkombëtare. Për të gjitha këto ja si shkruante gazeta «Vullnetari i Lirisë në Spanjë, më 1937: «Oficeri shqiptar Ymer Puka mori pjesë si vullnetar në Revolucionin Socialist në Rusi në vitin 1918. Ai i kishte dhënë besën Leninit për të luftuar deri në fund për lirinë e popujve. Për këtë ai erdhi edhe në Spanjë vullnetar me brigadat internacionale». Gjatë vitit 1937 u plagos dy herë. Pa iu shëruar mirë plagët e rënda, kthehet përsëri në front. Mbas disa luftimesh të ashpra, plagoset përsëri. Dërgohet për mjekim në veri të Spanjës, ku rastësisht njihet me shkrimtarë të ardhshëm, Petro Marko, të cilët në shkrimet e tyre thonë për të se «... ishte trupmadh, burrëror, i vendosur, trim dhe shumë i shkathët, por edhe shakatar dhe gazmor... Ai dinte disa gjuhë: turqishten, arabishten, rusishten dhe greqishten. Sesi më mbeti pa i dhënë vend në roman. Hasta La Vista shprehet shkrimtari Petro Marko. Apo se ishte larg brigadës sonë. Në Francë u lidh me luftëtarët e rezistencës kundër nazizmit gjerman, ku mbeti i vvarë si antifashist e luftëtar i lirisë së popujve. Xha Ymeri nuk duhet harruar kurrë e mbylli takimin me mua në kafe “Peza”, Tiranë!». Ymer Puka luftoi e jetoi larg vendlindjes dhe Atdheut, të cilin ia kishin mohuar pushtuesit, por u përjetësua si luftëtar internacionalist antifashist.

\*10 janar 1991

## Ministri Vengu: Shkolla “Skënderbej”, vatër e edukimit të brezave

(Vijon nga faqja 7)

në kuadrin e formimit të ushtrisë shqiptare, pas vitit 1944.

Deri në vitin 1992 shkolla “Skënderbej” ka marrë pjesë në të gjitha aksionet kombëtare të rinisë shqiptare, duke u dalluar veçanërisht në ndërtimin e hekurudhave Elbasan-Prrenjas, Milot-Reshneklos; në rrugën e Malësisë së Madhe, në ndërtimin e hidrocentraleve në Koman e Fierzë; në Kombinatin Metalurgjik Elbasan; në aksionet në ndihmë të bujqësisë në Myzeqe, Ksamil, Bizë, Zall Herr, Mirditë; në likuidimin e pasojave të tërmetit në Dibër (1967) dhe në Shkodër (1979). Skënderbegasit janë dalluar në mjaft koncerte festive, parada, spartakiada, olimpiada të shkollave të mesme, manifestime dhe stërvitje të rëndësishme të ushtrisë, duke underuar kurdoherë me çmime e vlerësime në rang kombëtar. Shkolla “Skënderbej” përfaqëson ekipet e të rinjve të klubit “Partizani” në të gjitha llojet e sporteve, duke nxjerrë sportiste dhe mjeshtër sporti të rangut kombëtar e ndërkombëtar. Shkolla “Skënderbej” gjatë historisë

së saj ka marrë vëmendjen që i takonte nga shteti shqiptar lidhur me kontributet dhe performancën e saj si një institucion cilësor arsimor në koherencë me zhvillimet dhe reformat në Forcat e Armatosura, duke mbajtur gjallë dashurinë për ushtrinë dhe popullin shqiptar. Ajo krijoi një traditë historike, e cila ka lënë gjurmë në ushtrinë tonë dje, sot dhe për të ardhmen, duke krijuar oficerin e ri shqiptar. Ajo pati meritën e përgatitjes së kontigjenteve për shkollat e tjera ushtarake, për rritjen e standarteve të larta për arsimimin ushtarak, duke u bërë terreni i provës dhe garancisë për suksese arsimore dhe profesionale të kuadrove të ushtrisë. Me dijet e përfituara në të gjithë hierarkinë e shkollave ushtarake, ish-skënderbegasit kanë bërë karrierë të shkëlqyer në radhët e ushtrisë, duke u bërë gjeneralë e ushtarakë madhorë, komandantë, specialistë, pilotë e detarë të shquar, ministra, profesorë e shkencetarë, deputetë e artistë të mëdhenj, sportistë e mjeshtër sporti, ambasadorë, poetë e shkrimtarë, gazetarë, biznesmenë, politikanë etj.

Për vlerat dhe meritat e saj shkolla “Skënderbej” është dekoruar me urdhëra dhe medalje, në krye të të cilave qëndron “Urdhëri i Lartë i Skënderbeut”, duke u bërë shembull frymëzimi për gjithë rininë shqiptare. Edhe sot, shkollat ushtarake kanë se çfarë të mësojnë nga historia dhe vlerat e kësaj shkolle. Akademia “Skënderbej”, që trashëgon emrin e shkollës së mesme ushtarake “Skënderbej”, është duke i çuar më përpara traditën e përgatitjes së oficerëve të FA Shqiptare në të gjitha fushat, si në ato të dijeve teorike, shkencore dhe tekniko-profesionale në baze të përvojës sonë dhe standarteve të NATO-s.

Oficëret e sotëm ish-skënderbegas vazhdojnë të shkëlqejnë jo vetëm në akademitë tona, por edhe në ato të ushtrive perëndimore. Shumë prej tyre janë duke punuar në misionet ushtarake jashtë Shqipërisë, në organizmat e sigurisë në Europë dhe në strukturat e NATO-s.

Shkolla u krijua si domoshmëri objektive dhe nevojë permanente e ushtrisë shqiptare për kuadro të aftë e të përgatitur me ar-

simimin përkatës dhe me formimin demokratik. Në vitin 1992 shkolla “Skënderbej” u mbyll, duke ndërprerë veprimtarinë e saj, duke humbur statusin si vatër kombëtare për edukimin patriotik, atdhetar e ushtarak, si fidanishte e kuadrove të ushtrisë. Sot mund të rishikohet kërkesa e përsëritur për ta rihapur këtë shkollë legjendare. Tradita dhe historia e saj, ndonëse kanë kaluar 28 vjet nga mbyllja, nuk do të harrohen e anashkalohen kurrë. Sot e në vazhdimësi, jo vetëm ajo pjesë e “pionierëve të luftës”, por edhe e brezat pasardhës janë

krenarë që militojnë në organizatën e veteranëve të LNÇL dhe sidomos në shoqatën kombëtare “Skënderbegasi”, e krijuar në vitin 1996.

Kjo shoqatë ka në girin e saj rreth 30 mijë skënderbegas. Ajo është kthyer në një vatër të ngrohte atdhetare për kryerjen e aktiviteteve promovuese të shkollës dhe të ushtrisë, të historisë së luftërave të popullit shqiptar ndër shekuj, të plejadës së skënderbegasve të kudondodhur, për të përjetsuar Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”.

## OPINION

# “24 Marsi i bombardimeve të ShBA/NATO për çlirimin e Kosovës”!

Gjeneral @ Piro Ahmetaj

**24** marsi 1999 do të mbetet i skalitur në historinë e NATO-s si “fillimi i fundit të pushtimi barbar të serbisë ndaj Kosovës”. Në “kapacitetin e ekspertit të Sigurisë Kombëtare, rajonit dhe marrëdhënieve me USA/NATO”, risjell në kujtesë rrethanat dhe peshën gjeopolitike të kësaj datë-ngjarjeje madhore:

Së pari, mbremjen e 23 marsit 1999, misionari i paqes, ambasadori mirënjohur Holbrooke dhe Gjenerali mirënjohur Westly Clark, u kthyen nga Beogradi në Bruksel: “të refuzuar cinikisht nga Millosheviçi” në përpjekjen diplomatike për të evituar ndërhyrjen ushtarake të NATO-s. Në orët e para të ditës tjetër, pra 24 mars fuqia ajrore e SHBA/NATO u angazhua një luftë “jashtë artikullit 5”, pra pa miratimin e KS/OKB-së, por që e legjitimoi NATO-n si “Aleancën e lirisë, paqes, shpresës dhe besimit të vlerat demokrate” në mbarë botën!

Kështu, 24 marsi 1999, simbolizon jo vetëm përvjetorin e një ngjarjeje të lavdishme për historinë gjeopolitike të NATO-s, por meriton të mbetet e skalitur në përjetësi nga shqiptarët edhe si data e mirënjohjes kombëtare ndaj fuqisë ushtarake të SHBA/ NATO-s.

Përveç kësaj, kjo datë-gjarje ndryshoi përjetësisht hartën gjeopolitike të rajonit, në favor Aleancës Euroatlantike si dhe të kombit shqiptar.

Edhe në situatën aktuale, 24 marsi mbetet një ngjarje me “mesazhe të forta shprese” për fundin që e pret Rusinë-Putiniste, e cila: “mbas mbi 3 vjet lufte barbare”. Ndërsa nuk ka mbetur asnjë dilemë, as për mendjet e ndryshkura jo vetëm në Beograd, që pikërisht për shkak të kësaj lufte, Kremli gjendet sot më i izoluar se asnjëherë me parë, ndërsa gjykata Ndërkombëtare ka lëshuar “urdhër arresti për krime lufte” ndaj Putinit dhe listën e zulumqarëve rreth tij.

Së dyti, shpreh keqardhjen për mungesën delekuente “të mirënjohjes institucionale nga Prishtina dhe Tirana zyrtare” përkundër domosdoshmërisë jetike që ka Kosova dhe Kombi ynë për forcimin e bashkëpunimit me partnerët strategjikë SHBA/NATO/BE!

E gjej zhgënjyese që mbas 26 vjet pavarësi, kryeçlirimtarët e Kosovës, pra Washingtoni zyrtar, ka ngritur një zhgënjim serioz: “për faktin se qeveria e Kosovës dhe Tiranës nuk po konsultohet dhe nuk po punojnë me SHBA për sigurinë rajonale”!

Shpreh revoltën jo vetëm për vendimarrjet e pakonsultuara me SHBA-të, por veçanërisht për riciklimin e kokëfortësisë bolshevike dhe të sovranitetit folklorik nga të gjithëpushtetshmit e Kosovës, ndaj politikanëve dhe opinionistëve mendjendryshkur në Prishtinë, Tiranë etj.

Duke përsëritur “përluljen ndaj dëshmorëve të atdheut si dhe nderimin më të thellë ndaj sakrificave për pavarësi të luftëtarëve dhe popullit të Kosovës në shekuj”, mbas 26 vitesh besoj edhe më fortë se në koshiençën fisnike të kombit të jetë përjetësisht e skalitur, që: “Çlirimi i Kosovës nga pushtuesit serbë nuk u arrit as vetëm nga luftërat, as nga qëndresat dhe as nga sakrificat e popullit të Kosovës”.

Shpresoj ta “pranojmë fisnikërisht” se vetëm falë ndërhyrjes së fuqisë ajrore të USA/NATO, Millosheviçi nënshkroi tërhequr forcave pushtuese (ushtarake dhe policore) deri në kufijtë e përcaktuar nga rezoluta 1244 dhe të shenjtëruar në Flamurin e Kosovës nga Sh.T. Presidenti Rugova. Për këtë, mjafton të sjellim qetësisht në vëmendje që në Marrëveshjen e Kumanovës, UÇK-ja nuk ishte as palë nënshkruese, as vëzhgues, edhe pse aty u vendos shkrijra dhe shndërrimi në Forcat e Sigurisë së Kosovës, ndërsa sig-

uria territoriale, iu ngarkua KFOR-it, me mbi 37 mijë forca këmbësorie nga 36 vende, anëtare të NATO-s dhe jo vetëm.

Prandaj, as ligjëratat marksiste dhe as bejtet patriotike mbi sovranitetin dhe të drejtat sovraane nuk do të mundën kurrësi të errësojnë rolin përcaktues të “çlirimtarëve të vërtetë” (SHBA) të Kosovës nga pushtimi serb dhe as peshën kritike që prej 26 vitesh, ato vijojnë të mbajnë për paqen, stabilitetin si dhe ardhmërinë euroatlantike të Kosovës.

Thënë këto, data 24 mars meriton të skalitet jo vetëm si data e mirënjohjes mbarëkombëtare ndaj USA-NATO, por edhe si dita e falënderimeve ndaj 36 vendeve dhe rreth 500 mijë ushtarakeve të KFOR-it, që për 26 vjet vijojnë të mbrojnë paqen në Kosovë dhe rajon.

Së treti, për shkak funksioneve që kam ushtruar 26 vitet e fundit, kam ndjekur me vëmendje të shtuar situatën e sigurisë në Kosovë dhe rajon. Sigurisht kam bërë detyrën që vlerësimet dhe rekomandimet strategjike për stabilitetin dhe sfidat euroatlantike të Kosovës, i kam prezantuar në forumet më të larta të sigurisë, në konferenca, panele, etj., si dhe mijëra faqe të publikuara në kryeqytetet e rajonit, përfshi Beograd; në Këshillin e Atlantikut në Qashington; me Ekspertë/kolegë të sigurisë në Bruksel, Qendrën Marshall, Gjermani, Kolegjin e Romës, në 32 vendet e NATO-s.

Ndërsa, 15 vitet e fundit: “shqetësimet strategjike mbi armatosjen deri në dhëmbë dhe (keq) shpërdorimin e Beogradit nga Kremli, Pekini dhe çuditërisht Parisi”, i kam adresuar si pyetje të thjeshta/publike, ndaj z.Vuçiç dhe gjeneralëve të tij: “Përse shpenzon më shumë se 1.5 miliard euro në vit për armatosjen me tanke; Mig-29; Rafalo; helikopter luftimi, raketa Pantsir-S, etj, dronë vrasës, etj? Përse 3/4 e strukturave dhe fuqisë ushtarake ofensive (jo siç i avokaton PMRSh Rama!) i ka dislokuar në kufijtë shtetërorë të Kosovës(?); nga cili vend apo Aleancë rrezikohet tërësia territoriale e Serbisë?; apo integritetin e cilit vend sovran, përveçse të Kosovës kërcënon Serbia?”


Nga ana tjetër, nuk kam asnjë mëdyshje, që 26 vitet pas çlirimit të Kosovës apo 38 muajt e luftës gjakatare në Ukrainë: “qëndrimet dhe veprimet e Beogradit Zyrtar, i gjej të sinkronizuara me interesat gjeopolitike të Rusisë në Ballkan”. Gjithsesi, Rusia Putiniste ka dështuar për të ndezur një front të ri lufte në rajon, duke frymëzuar dhe armatosur grupet kriminale në veri të Kosovës si dhe ekstremistët e tipit Dodik, për të mbajtur ndezur frymën antiperëndimore, apo duke e diskretuar Beogradin “deri me agresion ushtarak” jo vetëm ndaj sovranitetit territorial të Kosovës, por edhe kundër prezencës së shtuar të KFOR/NATO-s në terren.

Thënë këto, më duhet ta përsëris qartë, përfshi për gjeneralët dhe mendjet putiniste në Beograd (dhe jo vetëm) si dhe për sovranistët folklorikë të Prishtinës dhe Tiranës zyrtare: “Përsa kohë të ketë prezencë të SHBA-NATO në terren, agresioni ushtarak kundër tërësisë territoriale të Kosovës, përveçse aventurë vetëvrasëse e Serbisë mbetet një mision tërësisht i pamundur (zero)”!

Në vijim gjeni përmbledhje me “5 rekomandime strategjike” për sigurinë afatgjatë, dialogun konstruktiv, bashkëjetesën paqësore për ardhmërinë Euroatlantike të Kosovës dhe Serbisë:

1. Serbia dhe Kosova do duhet të tregohen seriozë për të zhvilluar masat e mirëbesimit reciprok dhe bashkëjetesës paqësore mes popujve, duke u konsultuar paraprakisht si dhe dhënë besim projektit të Presidentit Trump dhe NATO-s.

2. Beogradit zyrtar i duhet “të harrojë kërcënimet neo-Staliniste” për rikthimin e flamurit serb në vendin e krimeve kundër



njerëzimit, si dhe riciklimin e fushatave të përgjakshme ndaj territorit të Kosovës dhe popullit shqiptar.

Për të mirën e Serbisë, të mos shpenzoj kot 1.5 miliard euro në vit nga taksat/mundi i popullit serb, pasi ka zero, aftësi, ose këllqe të përballet me fuqinë ushtarake të USA/NATO-s dhe FSK në Kosovë; të heqë dorë nga ëndrrat për “të pirë” nga 5 nëna (Moska, Brukseli, Pekini, Parisi, dhe Washingtoni). Ndërsa, z.Vuçiç të mos riciklojë oshilonacionet e Millosheviçit dhe as të bëjë trimin tërbuar duke kërcënuar perëndimin (ose me Serbinë ose me Kosovën!); por as viktimën dhe as të irrituarin, pasi, siç është konfirmuar nga ekspertët e Pentagonit edhe 246 raketat ‘Javelin’ të miratuara nga DASH-SHBA për FSK, nuk janë kapacitete sulmuese, por vetëm për të ushtruar të drejtën sovraane të vetëmbrojtjes së tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës nga çdo armik potencial, që në fakt mbetet vetëm Serbia, apo jo?

3. Prishtina dhe Tirana zyrtare, pa u konsultuar me SHBA, kurrsesi nuk do duhej të marrë vendimarrje me impakte strategjike, që minojnë themelet e besimit me “çlirimtarët/USA, që prej 26 vitesh vijojnë të mbajnë peshë kritike për sigurinë dhe ardhmërinë euroatlantike të Kosovës”. Për më shumë, do t’i këshilloja vëllazërisht aktorët mendjehapur të Prishtinës që: “Çlirimi nga pushtuesit serbë më 1999 si dhe riciklimi i kërcënimeve ushtarake të Beogradit ndaj integritetit të Kosovës”, të mos i konsiderojnë me triumfalizëm populist, por si “përgjegjësi e lartë shtetërore për të ndërtuar Kosovën moderne”, përtej prezencës së NATO-s (që nuk do të jetë e përjetshme); vendin ku, qytetarët pavarësisht përkatësive etnike, fetare dhe politike të ndihen të barabartë para ligjit, si dhe faktorizimin e Kosovës nga konsumatorë, në kontribuues për sigurinë si dhe integrimin e rajonit në NATO dhe BE!

4. Tirana dhe Prishtina zyrtare e kanë përgjegjësi të lartë kombëtare dhe fisnike të demonstrojnë mirënjohje ndaj SHBA-NATOs. Ndërsa përkundër: “Vendimarrjeve të pakonsultuara dhe kako-

fonisë për protagonizëm internacionalist”, e çmoj si emergjencë kombëtare, ngritjen e një “Grupi të Urtësh – Wise Group”. me personalitete të gjithëpranuara, që përulen në gjunjë para historisë së përgjakshme dhe interesave kombëtare për t’i dhënë jetë një platforme të përbashkët “2-Shtete sovraane, 1-Komb i vetëm”, duke garantuar partnerët strategjikë se kjo “platformë e vonuar” do të kontribuojë si balancë racionale për paqen afatgjatë në rajon.

Sigurisht që: “ky projekt (2-Shtete 1-Komb), nuk ka kurrsesi lidhje me dallisjen bolshevike që vjen nga fuqia elektorale e mbipushtetit dhe as me pushtetarë kusarë që presin (duke u dridhur) radhën në SPAK; as me pluralizmin fasadë dhe as me mjerimin e opozitës të leckosur”.

5. Ndërsa, partnerëve strategjikë, aktorëve dhe ekspertëve/kolegëve në rajon, Qashington, Bruksel etj., do t’i risugjeroja që perspektivën e paqes dhe stabilitetin e rajonit, ta parakushtëzojnë me rikthimin e dy Masave të Mirëbesimit Reciprok, nëpërmjet të cilave Serbia “të imponohet” që: (1) do të ruajë balancat e fuqisë ushtarake duke mos kërcënuar integritetin territorial të Kosovës; (2) nuk do të vendosë instalime dhe as aktivitete ushtarake (25 km distancë ajrore dhe 10 km tokësore), në kufijtë shtetërore mes vendeve, dy kushte që gjithsesi do të duhen të monitorohen nga USA-NATO-BE, që mbeten faktorë kritikë për paqen në rajon.

Në përmbledhje, përkundër riciklimin të urrejtjes dhe gjakderdhjes shekullore, besoj edhe më fortë se 24 marsi 1999 do të mbetet një kampion alarmi ndërsa: “Paqja mbetet misioni i vetëm, në interes të sigurisë së jetës, pronës, mirëqenies së qytetarëve, si dhe ardhmërisë euroatlantike të Kosovës, të Serbisë si dhe 4 vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor”.

\*Autori: Gjeneral @ Piro Ahmetaj: Ekspert për SK, Rajonin e NATO-n, ZV.president i Këshillit Atlantikut dhe ish-këshilltar për Sigurinë Kombëtare në PD, Këshilltar i Presidentit, Zv/ShShPFA, Përfaqësues Ushtarak në NATO.

## KOSOVA

• *Nënshkrimi i Deklaratës për thellim të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, midis Kosovës dhe dy shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Shqipërinë dhe Kroacinë që janë pjesë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), me siguri do të shpejtoj integrimin e Kosovës në strukturat evropiane-atlantike*



## BOMBARDIMET E NATO-S PARA 26 VITEVE NGJARJE E MADHE HISTORIKE PËR SHQIPTARËT

**Nga Bashkim Hisari**

**B**ombardimet e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), mbi caqet ushtarake dhe policore në ish Jugosllavi para 26 viteve dhe përfundimi i luftës në Kosovë, krijoi kornizë të re të sigurisë dhe stabilitet në rajon dhe ishte e mbetet ngjarje më e madhe historike për shqiptarët e Kosovës.

Pas shumë përpjekjeve të pasuksesshme për zgjidhjen e konfliktit mes Prishtinës e Beogradit në rrugë diplomatike me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, dy konferencave të dështuara në Rambuje e Paris dhe pasi zyrtarët e lartë të NATO-s, nuk arritën të bindin udhëheqësin e atëhershëm jugosllav, Slobodan Milosheviq, që të tërhiqej, më 24 mars 1999, avionët e NATO-s, nisën fushatën ajrore dhe qëlluan një numër objektivash të ushtrisë e policisë serbe në disa nga qytetet e mëdha në Serbi, Kosovë e Mal të Zi.

Sipas këtij plani, tërësia e detyrave duhej të zbatohet në tri faza. Ishte parashikuar që faza e parë të kryhej gjatë muajit janar 1999, e që kishte për qëllim spastrimin etnik të popullsisë shqiptare në pjesën veriore të Kosovës. Faza e dytë ishte planifikuar të zbatohet gjatë muajit shkurt, që përfshinte pjesën qendrore të Kosovës, Drenicën dhe rajonin përreth, ku përveç vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare, synonin edhe shkatërrimin e njësitëve të UÇK. Faza e tretë, gjatë muajve mars dhe prill 1999, përfshinte veprimet për spastrimin etnik në tërë Kosovën. Për këtë qëllim, strukturat ushtarake komanduese dhe politike të Serbisë, kishin hapur tri vendkalime kufitare, dy me Shqipërinë, në Vermicë dhe Morinë, një me Maqedoninë, në Han të Elezit - Bllacë dhe një tjetër pikëkalim kufitar me Malin e Zi, në Kullë. Mëse 150 mijë forca ushtarake, policore

dhe grupe paramilitarësh si: “Dora e zezë”; “Shqiponjat e bardha”; “Ujqit gri”; “Ujqit e zinj”; “Skorpionët”; “Tigrat e Arkanit”, të njohur edhe si “Garda e vullnetarëve serbë”; “Leopardët e përgjakshëm”; “Çetnikët e Zhupës” të kriminelit Vojislav Sheshel etj., me tërë arsenalin e tyre vrasës ishin të dislokuar gjithandej Kosovës. Meqë nuk ishin në gjendje të përballen me fuqinë ajrore të NATO-s, ata intensifikuan veprimet e tyre të krimeve më të rënda. Ndaj civilëve shqiptarë silleshin si trupa sulmuese ndëshkimore, vetëm për të vrarë, për të djegur e për të plaçkitur gjithçka. Afro një milionë shqiptarë u larguan nga Kosova, shumica me dhunë u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Procesin e dhimbshëm të dëbimeve, autoritetet serbe e shoqëronin me justifikime dhe manipulime se kinse shqiptarët po largohen nga trojet e tyre për shkak të “bombardimeve të NATO-s dhe sulmeve terroriste të UÇK-s”.

Sipas të dhënave të vërtetuara dhe publikuara, 13.535 persona janë vrarë, nga numri i përgjithshëm i viktimave 10.317, mbi 80%, kanë qenë persona civilë, të cilët nuk kanë marrë pjesë në luftë. Ndërkaq, numri i personave të pagjetur sipas të dhënave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe të organizatave të tjera që mirren me të drejtat e njeriut, ishte 1612 nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s, vrasjet ishin të përditshme, të qëllimshme, ëë paligjësme dhe rrezikonin gjithë shqiptarët pa dallim. Ish Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në akademinë përkujtimore që u organizua në 20-vjetorin e masakrave në fshatrat Qyshk, Pavlan, Zahaq dhe Llabjan, përmendi 400 masakra kundër shqiptarëve.

Ndër masakrat masive më të njohura dhe të dokumentuara janë: Masakra në Fortesë (ish Bellacerkë), më 25 mars 1999, ku serbët masakruan 65 civilë shqiptarë. Në Celinë, më 25

e 26 mars 1999, u vranë 86 civilë. Në Krushë të Madhe, më 25, 26 e 27 mars 1999, u ekzekutuan mbi 264 civilë shqiptarë. Në Krushë të Vogël, më 25 e 26 mars 1999, u ekzekutuan dhe u dogjën trupat e 113 martirëve. Në Izbicë, më 28 mars u masakruan 147. Në Rudin (ish Pastasellë) më 31 mars 1999 u masakruan 110 civilë. Në komunën e Gjakovës u vranë rreth 1600 civilë. Në Poklek më 17 prill 1999 u masakruan dhe u dogjën trupat e 53 viktimave. Në Meje, më 27 prill 1999 u vranë 376 civilë. Në komunën e Therandës (ish Suharekë) janë vrarë 379 civilë, ndër ta 76 fëmijë. Në Burgun e Dubravës, 19-24 maj 1999, brenda burgut janë vrarë 160 të burgosur politik shqiptarë dhe janë plagosur më shumë se 300 të tjerë.

Shumë trupa nga këto masakra u gjetën më vonë në Qendrën për trajnimin e njësitëve speciale të Ministrisë për Punëve të Brendshme kundër Terrorizmit në Batajnicë, afër Beogradit, ku regjimi serb përpiqej të fshihte gjurmët e krimeve të luftës.

Ata, me gënjeshtër të dëshmuara dhe të verbuar nga ideologjia e politikës luftarake, ende pretendojnë se Kosova është Serbi. Njerëzit e tyre i shpiejnë në deluzione që nuk kanë të bëjnë fare me realitetin.

Kuvendi i Kosovës, njëzëri shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Kosova tani është faktor në skenën ndërkombëtare. Ka kufijtë, Kuvendin, flamurin, himnin e saj. Shumica e shteteve anëtare të BE e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Këtë të vërtetë duhet të dijnë të gjithë në Serbi duke përfshirë edhe filloristët që lexojnë abetaren. Por, Serbia po qeveriset nga diletantët e plotfuqishëm politikë, që po e mbajnë popullin serb peng me “politikën e tyre kombëtare”. Manipulojnë me Kosovën, tregojnë përralla dhe bëjnë pazare pas krahëve duke theksuar se “Kosova është Serbi”, “Kosova është fjala më e shtrenjët

serbe” dhe krijojnë privilegjë dhe pasuri.

Kosova kurrë nuk ka qenë serbe. Në vitin 1912, u bë pjesë e Serbisë, nën okupimin ushtarak. Edhe gjatë viteve 1918-1941, në Mbretërinë Jugosllave, nuk ishte e Serbisë sepse Mbretëria përbëhej prej “Banovinave”-njësive administrative të Maqedonisë, Malit të Zi, Sanxhakur, Kosovës. Pas Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e Kosovës organizuan, ngjarjen e madhe në historinë e kombit shqiptar - Konferencën e Bujanit ku u afirmua e drejta e vullnetit të popullit kosovarë për liri, vetëvendosje dhe dëshirën për t’u bashkuar me Shqipërinë. Por, çështjet e Kosovës dhe të vetëvendosjes nuk u morrën parasysh dhe Kosova sërish me dhunë mbeti pjesë e Jugosllavisë. Me miratimin e Kushtetutës të vitit 1974, Kosova arriti një status pothuaj të barabart me republikat që përbënin Jugosllavinë - status që shërbeu si një ndër pikat mbështetëse të kërkesave për Republikën e Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran. Por, Slobodan Millosheviqi, me forcë tentoi ta rrëmbejë Kosovën. Pastaj ndodhi lufta e UÇK-s dhe bombardimet e NATO-s. Në fund u nënshkrua një marrëveshje ushtarako-teknike në Kumanovë, me të cilën Serbia pranoi të tërhiqej nga Kosova.

Pas shpalljes së pavarësisë, shqiptarët në Kosovë, bashkë me komunitetet tjera jetojnë të lirë, por me plagë të rënda që ka shkaktuar regjimi serb. Pjesa më e madhe e popullsisë në Kosovë nuk duan të jetojnë me Serbinë, por dëshirojnë të jenë antarë të BE. Javë më parë, nënshkrimi i Deklaratës për thellim të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, midis Kosovës dhe dy shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Shqipërinë dhe Kroacinë që janë pjesë e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), me siguri do të shpejtoj integrimin e Kosovës në strukturat evropiane-atlantike.

## OPINION

# TOFIK RAMA I TEPELENËS DHE SHOKËT E TIJ TË USHTRISË

NGA MEVLUD BUCI

**N**ga Lukani i Dibrës mora një telefonatë:

-Alo! Jam Tofik Rama, shoku juaj i ushtrisë. Ju flas nga malet e Tepelenës!

Ndjeva një përlojtje dhe e përgëzoza. Tofik Rama dhe shokët e tij të ushtrisë së asaj kohe u shokuan kur mësuan se gjeneralin Rrahman Parllaku, njeriun qëndrestar, diktatura e kishte dënuar...

Tefik Rama, sot mbi të 70-tat, së bashku me Kadri Pilën, Bashkim Jerajn atëherë ishin tre tepelenas shembullorë në llogoret buzë Erzenit. Djem të rrallë, njerëz fisnikë e shpirtbardhë.

Vitet shkojnë dhe sot më kujtohen ata njerëz që na mësuan artin ushtarak, disiplinën dhe dashurinë për atdhe... dhe nuk mund të harrohen lehtë ndërsa një telefonatë e rizgjon furishëm kujtesën e kohërave.

Ndaj, rrojnë e nuk harrohen kurrë ushtarakët e shquar, si: Petrit Shtëpani, Selim Pira, Kadri Hida, Jorgo Llana, Janaq Tërpo, Zaho Hila i Progonatit e plot të tjerë.

Ata iu përkushtuan detyrës, stërvitjes dhe nderimit për ushtarët.



Dhe sot janë veteran ish-ushtarakët shembullorë të regjimentit të Ndroqit(9319) "Dushku" si Tofik Rama, Kadri Pila, Bashkim Jera, bij të nderuar të Tepelenës.

Ata njohën dhe mësuan shumë nga traditat atdhetare të Pezës dhe të Ndroqit dhe ia merrnin këngës shtruar-labçe, ku printe Bashkim Jeraj dhe pasonin Tofik Rama e Kadri Pila.

Nga të gjitha vlerat e jetës, vlerat e ushtrisë janë më të skalitura sepse ndërtohen përmes sakrificave. Nda-

j, sot si veteran ata ndihen krenarë, sepse kanë lënë gjurmë dhe nderim tek shumë njerëz që i kanë njohur, por edhe në historinë e ushtrisë shqiptare.

Tofik Rama nuk i harron kurrë shokët edhe pse kanë kaluar sa vite. As ato vende që i mati me pëllëmbë e krijoi situata luftarake të stërvitjes, si: kalanë shekullore të Ndroqit, Kërçukjen, Çolajbërzesin, brigjet e Erzenit.

Të nderuar e të paharruar mbeten Misto Teli Margariti, Kozma Çuko, Fehmi Puci, Sabri Meziu, Izet Sallahi,

Shkëlqim Sulë Çenga i Dibrës, Rrok Pllumbi i Tamarës, Neshat Çala i Cërrikut, Lad Dogana, Nikolla Gjoka. Si dhe Bardhyl Kila, dajrexhiu-mjeshtër, i Elbasanit.

Sot ata janë të thinjur, por me nder se janë veteranë dhe e mbajnë me krenari këtë fjalë të madhe që të kujton kontribute të çmuara.

Kurrë nuk harrohen shokët e ushtrisë të lidhur me transhetë, me baltën e dheun e tokës.

Të urtët e të thjeshtët si Qatip Sufa i Dibrës, Shkëlqim e Sulë Çenga, Lazarin Larja, Gëzim Zeko, Kozma Çuko e Misto Margariti, bashkojnë krahnat e Shqipërisë në një zë, në zërin e ushtrisë dhe të sakrificave, ku u kalit miqësia ushtarake. Koha dhe jeta nuk harrojnë gjurmët e shokëve veteranë, bij të llogoreve dhe shokë të armëve që ndenjën kurdoherë me sytë te flamuri dhe te drita e miqësisë në jetën ushtarake, një jetë e sprovuar në sfida e sakrificave.

Ndaj, ky shkrim gdhend disa fjalë kujtese dhe nderimi për Tofik Ramën e Tepelenës dhe shokët e tij të ushtrisë, fjalë që në bronzin e kohës nuk vyshken kurrë...

## ESSE

## DESHMORET NGA NIVICA, NEVRUS REIZ XHAKA DHE AVDYL MUÇO LOPA NE PERMBUSHJE TE MISIONIT

NEKI ÇAKO

Pa dëshmorët nuk mund të qëndrojnë në këmbë ky komb. Ata janë rrënja,

që nga gjaku i tyre ushqehet kjo tokë. Lufta Antifashiste - Nacional - Çlirimtare është e shenjtë, mbi të shenjtat, me idealitet humane nga më të lartat, sepse

ffjala dëshmor në thelb do të thotë, njeri që ka dhënë jetën me dëshirë për Atdhe! E si mos të shkruajmë ne, që t'i kujtojmë sot këto figura, që në moshën

fare të njomë, në moshën më të bukur, në lule të rinisë, ranë me fjalën në gojë! Sot s'duhet të kursehemi, jeta jonë i përket popullit dhe Atdheut!



**N**evruzi lindi në fshatin Nivicë të Tepelenës në vitin, 1926 në një familje fshatare shumë të varfër dhe u rrit në skamje e varfëri! Jeta e tij do të ishte tepër e vështirë pasi ai ishte edhe jetim. Pa mbushur vitin atij do ti ndërronte jetë e ëma dhe me vonë do të rritej në kushte të mjerueshme. Gjatë luftës italo-greke nga dora fashiste do të vritej edhe ati. I rritur në vështirësitë e kohës, në varfëri dhe në mungesë të prindërve ai do të burrohej para kohe. Urrejtja që kishte në shpirt do ta bënte atë edhe më aktiv duke u rreshtuar në kra-hun e luftës nacional çlirimtare, duke krijuar një urrejtje të madhe për pushtuesin. U angazhua në radhët e rinisë së fshatit duke kryer detyra të vështira, në mbështetje të lëvizjes. Në fil-

lim të vitit 1943 do të rreshtohet në radhët e ushtrisë Nacional- Çlirimtare. Ai ishte ende i vogël në moshë. Pas shumë lutjesh e ndjekje nga mbrapa të batalionit "Asim Zeneli" atë do ta pranonin në radhët e tyre. Ai do të merrte detyrën e korierit të batalionit, së bashku me një shokun e tij, po nga fshati Nivicë edhe ai i brymosur me urrejtjen për pushtuesin, me Avdyl Lopa edhe ai në moshë fare të re.



**A**vdyl lindi dy vjet më vonë se Novruzi, në vitin 1928 po në të njëjtin fshat në Nivicë. Moshë dhe urrejtja ndaj pushtuesve I bashkonte. S'kemi kohë të presim. Pas aktiviteteve të përbashkëta në fshat ata nuk do të rrinin duarkryq, por ju ngjiten batalionit në pritje të detyrave të reja. Pasi morën detyrën ata u nisën në përmbushje të misionit të ngarkuar. Gjatë rrugës pa arritur në destinacion në fshatin Zhulat, ata do të binin në sy të pushtuesëve gjermanë të cilët i rrethuan. Luftimet filluan të ashpra. Novruzi thërriste me zë të lartë. "Me ju o fashistë të ndyrë tash e mbrapa do të flasim me grykën e pushkës". Armiqtë ishin të shumtë në numër. Lufta u ndez e ashpër. Mirëpo trimat sulmonin, e as që u trëmbej syri. Municioni po u mbaronte dhe ata nuk mundën ta çanin rrethimin. Pas shumë orësh përpjekje, dhe

duke qënë edhe në epërsi në numër, forcat fashiste mundën ti kapnin dhe t' i shoqëronin në kampin armik. Torturat ishin nga më ç'njerzoret. Pas shumë orëve tortura që ju bënë, për të treguar rolin e tyre dhe për të treguar shokët dhe bazat e luftës ata vendosën ti pushkatonin. Edhe pse ata u torturuan barbarisht, me mënyra nga më ç'njerzoret, nga goja e tyre nuk nxorrën asnjë fjalë. Duke mos mësuar gjë, gjermanët të xhindosur i pushkatuan. Për këtë akt sublim dhe vetmohues ndaj Atdheut, Presidiumi i Kuvëndit Popllor j'u ka akorduar titullin "Dëshmor i Atdheut" duke i dekoruar ata edhe me medaljen e Trimërisë dhe atë të Çlirimit. Lavdi të përjetëshme dëshmorëve të Atdheut!

## REPORTAZH



Nga Nuri Bufi

# Durrës, 7 marsi bën bashkë mësues, nxënës dhe shkrimtarë

në punë të ushtrimit të fesë dhe me këtë rast ,ai la me shkrim disa porosi dhe udhëzime për klerin Katolik,ndër të cilat dhe formulën e mësipërme ,të cilën mund ta përdorin prindërit për të pagëzuarfëmijët e tyre ,në rastet kur nuk kishin mundësi t'i dërgonin në kishë , ose kur nuk kishte prift. "Formula e Pagëzimit"në shqip është gjetur në bibliotekën Laurentiana të Milanos.

Si i pari monument letrar i botuar në gjuhën shqipe ,deri më sot njihet vepra "Meshari",shkruar nga prifti katolik shqiptar Gjo Buzuku më 5 janar të vitit 1955,deri atëherë nuk ekzistonte përktihme në shqip të shkrimeve të shenjta Biblike. Pushtimi otoman ,filluar në fundë të shekullit 14 dhe i përfunduar më 1912 ,do të ndryshonte tërësisht asetet fetare dhe shoqërore të mëparshme .E megjithatë raportet politike dhe kulturore me Romën e përgjithësisht me perëndimin ,nuk u ndërpre asnjëher . Nga miti i Skënderbeut si arbëresh, pati një rëndësi të madhe për botën shqiptare dhe Italo-shqiptare.

Papa Klementi 11,Albani 1700-1721 e drejtoi interesin e kishës katolike drejt Ballkanit dhe dukshmërisht drejt Shqipërisë,nga e cila ishte i vetëdijshëm që rridhte familja e tij .

Më 1703 do të kremtonte koncilin provincial shqiptar , pra kuvendin e Arbërit ,aktet e të cilit ,të shkruara në shqip ,përbëjnë një dëshmi të çmueshme të zhvillimit të liturgjisë e leksigut shqip,

Rilindasit, personalitete të shquara ,Patriot të diasporës dhe Intelektual të lexuar e të kënduar nëpër botë ,të cilët dhanë gjithë kontributin e tyre material e shpirtëror ,duke ju kthyer vendit e kombit të tyre pa sublime .Si të till ish in P.Sotiri,N.Veqilharxhi ,K. Kristoforidhi, P.N.Luarasi, N. Frashëri ,S. Frashëri ,P. Vasa, N. Naçi ,TH, Avrami ,N, Mjeda ,H, Tasim ,GJ, Fishta ,J, Vreto, Z .Jubani etj .Kontributi i tyre qe mes territ e ferrit të kohës ,të cilët qenë të shumtë ata që u flijuan dhe u masakruan nga armiqt e jashtëm dhe të brëdshëm ,si P .Sotiri ,P .N. Luarasi ,P .K. Negovani etj.

Në përpjekje e sakrificime të mëdha ,këta atdhetar lanë mënjan ndarësit fetare ,ato krahinore dhe u bënë bashkë për çështjen e gjuhës dhe arsimit kombëtar.Shkolla shqip –folëse në mënyr sporadike janë hapur që në kohëra të hershme të ndikuara edhe nga kultet fetare , si në Ulqin në vitin 1258 ,në Durrës më 1278, Shkodër më 1345,Tivar më 1359, Himar më 1633,Kurbin,Pllan,e Blinisht më 1638.

Dhe pas shumë përpjekjesh shkolla e parë zyrtare në gjuhën shqipe u hap në qytetin e Korçës më 7 Mars 1887 në kohën e Perandorisë osmane, kjo datë festohet nga shqiptarët si dita e mësuesit .Pas dy vitesh shkolla shqip –folëse u hap në Prizëren më 5 maj 1889.

Së treti nga ky eviniment festiv doli në pah dhe qëllimi ,ideali i përkushtimit të patriotëve dhe rilindasve tanë

e gjatë ndërshekullore e drejtpërdrejt si dhe ajo diplomatike nga ana tjetër me ndërgjegjësimin e kombeve të tjera ndër konventa të fuqive superiore ,u bë e mundëshme targimi i virtyteve të kombësisë ton me njohjen e gjuhës ,me hapjen e shkollës shqipe. Më tej nga ky manifestim u theksua roli i mësuesit si edukator i fëmijëve dhe gjithë brezit te ri .Mësuesit me pasionin e tyre të veçant,insistojnë në përgatitjen e nxënësve jo për kohën që ata janë në bankot e shkollës ,por për kohën që ata do të dalin në jetë,në përballje me sfidat që lyp shoqëria në të ardhmen. Festa ja arriti qëllimit ,më shumë se dy orë ,ansambli i këngëve dhe i valleve të shkollës së bashku ,Mësues,Nxënës,Poet dhe artistet,kënduan ,lexuan dhe ngritën në art fjalën e bukur shqipe ,kurorëzimiti së cilës i shtoi vlerat kësaj feste gjithë kombëtare.

Në mbyllje të këtij programi festiv ,nga kryetari i "Shtëpisë së Shkrimtarëve dhe Artistëve"Durrës,Zoti Agim .L. Bajrami,në bashkëpunim me këshillin Pedagogjik të shkollës "Turgut Ozal"të kryesuar nga drejtoresha e kësaj shkolle Zonja Frida Merdani,dhurohen dhe nderohen me çmimin letrar "7 Marsi"disa nga poetët mësues më të spikatur të qytetit të Durrësit si Eva Kacanja,Vaso Papaj ,Ilir Paja, Alma Begaj, Hasan Shahinaj, Hashim Kërtusha, Merita Thartori,Kuci, mësuesin,Publicistin e njohur Hajri Nuhu, mësuesen



në krahësim me Buzukun. Këta faktor historik e të tjera përbënin dhe faforizonin më së miri njohjen e mëvetësisë si komb me gjuhën e tij .

Në fokus të analizës së rrjedhur nga faktorët ndikues në formimin dhe përhapjen e gjuhës ,mbeteshin kushtet faforizuese e ato disfaforizuese në kohët e hershme. Si i vetmi faktor faforizues në përpjekjen për hapjen e shkollës shqip-folëse ,ishin faktori i brëndshëm,ashtu si faktor disfaforizues mbetej faktori i jashtëm .Në faforizimet përfshihen gjithë përpjekjet,sakrificat dhe lufta e bërë nga

në kurorëzimin e leturgjisë,me hapjen e shkollave shqipe në vendin tonë ,në thelb do të aspironin këto qëllime idealizuese :Populli ynë si komb shqip –folës mishëronte kulturën e tij si dhe traditat,doket ,këngët e gurrat popullore që i këndoheshin trimërive e betejave mes pabesive të huaja në kohëra,gëzonin më vete shprehjet në gëzime e ligeshimet e tyre .Të gjitha këto virtyte përbënin mëvetësin e këtij kombi si qëllimi final ,të cilat deri shumë kohë me parë ju mohoheshin dhe ju shkeleshin nga kundërshtit e huaja . Një luftë

veterane Fadile Agalliu,Haxhaja si dhe artistët kombëtar të njohur Zoti Idris Balani dhe Zoti Naim Kërçuku.

Çmimi "7 Marsi" ju akordua dhe këshillit pedagogjik të shkollës "Turgut Ozal", drejtuar ky institucion nga drejtoresha Zonja Frida Merdani. Dhe një mirënjohje e veçant shkon për mësuesen e pasionuar e kësaj shkolle Zonja Suada Leka për përgatitjen e mbarëvajtjen e këtij aktiviteti festiv.

**Gëzuar "7 Marsin" mësues të dashur, si festë drite, festë bashkimi, festë përparimi.**

**M**e rastin e 138 vjetorit të hapjes së mësonjtore së Parë Shqipe më 7 mars 1887 në qytetin e Korçës, si dita e bekuar e gjuhës shqipe ,në sallën e shfaqjeve pran shkollës "Turgut Ozal"manifestuan bashkë Mësues, Nxënës të kësaj shkolle dhe në prani të Shkrimtarëve dhe Artistëve Durrës.

Ky eviniment tepër emocional dhe i tej zgjatur ,bashkë me frymën entuziaste që sollën mjaft këngë dhe valle nga ansambli folklorik i shkollës ,me demosrimin e motivëve me karakter popullor si dhe ato me karakter patriotike atdhetare.

Me interes u pritën dhe shumë kumtesa ,të sjella nga mësues nxënës dhe nga shkrimtarët dhe artistë,veç respektit të thellë,për ata që bënë të mundur hapjen e mësonjtore së Parë Shqipe të Korçës ,nënvizuan dhe vështirësit e mësimin të gjuhës shqipe ,në fshehtësi në kasollet e fshatarëve ,pranë staneve të çobanëve,në shtëpi të thjeshta ,në objekte kulturi etj.

Nga përmbajtja e mjaftë kumtesave të referuesve dilyn në pah shkëndija drite që shquanin faktorët ndikues që çuan në hapjen e shkollës në gjuhën shqipe.

Faktori i parë cilësohet ai me karakter historik,që çeli dritarëzën e shumë pritur."Cicëroni",filozofi dhe historiani Italian ,që në kohët e lashta thot : "O popuj ,ruani një rëndësi të madhe ,se nëpërmjet tyre do t'u njohë bota". Teza e albanologëve shqiptar e argumentuar se gjuha shqipe ,burimin e ka në gjuhën indoevropiane ,e cila ka gjetur përdorim që në kohën para lindjes së krishtit,origjina e saj vjen para epokës së re .

Nga periudha e mesjetës ,si figura më e spikatur Arbërore mbetet heroi kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeu ,si figur mesjetare dhe iluministe ,prevaloi denjësisht deri tek rilindasit tanë më lëvrimin dhe formimin e gjuhës shqipe e nëpërmjet saj atë të njohjes si komb shqip folës.

Dokumenti i parë i datuar që njihet gjer më sot në gjuhën shqipe është "Formula e Pagëzimit",e vitit 1462 .Eshhtë një fjalë e shkurtër në gjuhën shqipe "Unte paghesont premenit Atit et birit et speritit senit",që gjendet në një qarkore të shkruar në latinisht nga Kryepeshkopi i Durrësit Pal Engjëlli ,bashkepunëtor i ngusht i Skënderbeut . Pal Engjëlli ,gjat një vizite në Mat ,vuri re çrregullime

## HISTORIA

# KUVENDI DHE BESA SHQIPTARE NË SENICË TË DELVINËS

(Në kuadrin e 255 vjetorit të Kuvendit të Senicës (1770-2025), ose "kuvendi i palcimit/pajtimit", të mbajtur më 25 mars 1770 (ditën e diel) nën drejtimin e legjislatorit të madh popullor agait të njohur Idriz Sulli dhe me mbështetjen e fuqishme të organizatorit dhe mikpritësit seniciot kryeplakut e drejtuesit të çetës patriotike të fshatit Senicë Kostë Prifti)

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI



mençurisht shkoi në Senicë më 1770, duke u bërë përbashkues i gjithë rrethinave, kazave e nahijeve të Jugut, në Kuvendin e Senicës, ku vargëzimi popullor thotë: "Gjëmon vëndi me oshtima, / Vijnë kalorës, vijnë trima, / Nga Himara, nga Smokthina, / Nga Labova nga Delvina...", që i jep dimension në mbarë jugun e vendit për pjesëmarrje të gjerë dhe angazhim serioz. Kënga u rregjistrua dhe u kic në mendjen e njerëzisë, nuk u harrua kurrë në breza, këndohet e ndonjëherë dhe përsoset në vargje rrugës, por ruan anonimitetin popullor për këtë organizim të pazakonshëm kuvendor në Senicën historike. Edhe sikurse thamë që nuk kishim "sekretari kuvendi", kishim rapsodin popullor vigilent që rregjistroi pjesëmarrësit përmes këngës, edhe pse nuk rregjistroi autorësinë duke i vendosur emrin "popull".

Emrat e kapedanëve janë gdhendur në këngë: "Krishto Koka nga Vunoi, / Jani Milo nga Himara, / Spiro Gjika nga Qeparoi, / Miho Gjini nga Piqerrasi, / Qesko Hila nga Lukova, / Hajdin Shehu nga Kalasa, / Stefan Prifti nga Shënvasia, / Kolë Mili dhe Jano Kumi nga Nivicë Bubari, / Dajkua i Lëkurësit (ka mundësi që emërtimi "dajkua" sipas burrave të moçëm të ketë qenë dajkua i tekstshkruesit popullor ose si vëllai i nënës së Kostë Priftit), / Bedo Hodo nga Borshi, / Demir Dosti agai i Kardhiqit, / Kostë Prifti nga Senica, / Toto Rusha Progonati, / Idriz Sulli nga Zhulat Fushëbardha, / Osman Sina nga Tatzati, / Sheh Sejkatit nga Filati, / Dalani nga Konispoli, / Kallapodhi i Delvinës, / Zoto Mahmuti Smokthina, / Igumeni i Katerinës nga Çamëria, / Allajbeu i Navarricës, si dhe mjaft të tjerë, që kënga si përmend emrat e tyre, por që është e njohur që ishin prijësat e kapedanët e çdo fshati, por edhe më gjerë. Kuvendi i Besës në Senicë ishte historike për trevën dhe historinë e shqiptarëve, ishte moment i bashkimit e pajtimit mes komuniteteve fetare dhe etnike. Kuvendi u udhëhoq bindshëm dhe mençurisht nga figura të njohura si: Idriz Sulli, një figurë e njohur e mençurisht dhe miku i tij i besës dhe betejës për drejtësi Kostë Prifti që hapi dyert mikëpritëse të seniciotëve.

Kuvendi ishte një mirëkuptim i plotë për zgjidhje konfliktesh dhe për bashkëjetesë e harmoni fetare. Në kohën kur shumë pjesë të Ballkanit përlësheshin në konflikte fetare e etnike, Kuvendi i Besës në Senicë përfaqësoi shembullin më tipik të tolerancës fetare dhe bashkëjetesës në këtë krahinë lavdiplote. Element deciziv i Kuvendit ka qenë vendosja e një atmosfere të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht besimeve fetare. Në atë kohë ishin vendosur si simbole të dy besimeve të pranishme, Bibla dhe Kurani

në një kamare ku janë edhe sot e kësaj dite, një simbolikë e bukur e zgjidhur mençurisht, ku vlerat e bashkëjetesës dhe respektin ndaj njëri-tjetrit, qëndronin mbi interesat individuale. Kuvendi i Besës në Senicë përveç çështjes së bashkëkëzistencës paqësore ndërfaqetare u ndal gjatë edhe tek fenomenet problemore shoqërore dhe politike të kohës. Fokusi ka qenë tek ndalja e fenomenit të gjakmarrjes e hakmarrjes, si një pengesë e madhe për stabilitetin dhe përparimin e shoqërisë shqiptare. Kuvendi miratoi dhe dha mesazhe të qarta për bashkëjetesë e bashkëpunim ndërmjet komuniteteve të ndryshme aq shumë të dëshirueshme. Përmes përpjekjeve për të zgjidhur konfliktet dhe për të vendosur parime të përbashkëta të drejtësisë dhe respektit, pjesëmarrësit në Kuvendin e Besës në Senicë demonstruan vullnet të plotë për një shoqëri të drejtë, të ndershme dhe të qëndrueshme.

Historia i njeh tashmë dy kamaret e 1770, në Senicë ku u vendosën Kurani dhe Bibla, si librat e shenjtë, vendosën Ungjilli dhe Kurani, për t'u betuar secili pjesëmarrës, sipas besimit të vet, me një akt demostativ jetësor, filozofik e patriotik. Rreth një shekull pas Kuvendit të Senicës, Vaso Pasha (1825-1892) shkroi vargjet manifest të Rilindjes Kombëtare shqiptare, lapidar të shekujve: "Feja e shqiptarit asht shqiptaria". Bibla dhe kurani në Senicë, por dhe në Taroninë pranë Fushëbardhës e Zhulalit, u bënë simbol i bashkimit pa dallim feje, hasmërie, pa gjaksi dhe pa hajdutëri, të gjithë në një front kundër sundimit të gjatë osman. Ky kuvend mbetet një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Shqipërisë, duke treguar aftësinë e popullit shqiptar për të zgjidhur konflikte dhe për të përparuar drejt një të ardhme të përbashkuar. Në lidhje me datën e saktë disa historianë e lidhin me kalendarin "allaturka" dhe "allafrënga" pra data e mbledhjes në 25 mars i shtojnë dy javë dhe e rregjistrojnë më 10 prill dhe vijueshmërinë tre ditore të kuvendit, por më mirë këtë çështje e zgjidhin burimet më të besueshme dokumentare edhe përtej arkivave shqiptare, pse jo edhe në Vatikan, në arkivin osman dhe arkivat e Venedikut e më gjerë. Tre vite pas Kuvendit të Senicës u mbajt një tjetër kuvend i planifikuar që në Senicë të mbahej në një vend asnjëherë tek Rrapet e Agait pranë Taroninës. Ky kuvend solli për zbatim "shtatë Shartet e Idriz Sullit" që u bënë të detyrueshme për zbatim për gjithë trevat e Jugut.

Këto gjenden edhe në përmbledhjen që u ka bërë Prof Ismet Elezi edhe në botimin e mirënjohur "Kanuni i Labërisë". Senica tashmë përbri autostratës së re dhe që

deri brenda fshatit ka shkuar rruga asfalt vitin që kaloi është rilindur. Bijtë e këtij fshati vijnë traditat mbajnë unitetin dhe miqësinë me të gjithë, duke rrezaturar zemërbardhësi, miqësi e kulturë, duke nxjerrë në pah se janë pasardhës të denjë të botës seniciote stërgjyshore. Besa e Kuvendit është kthyer në festë të përvitshme natyrisht me nismëtarët vizionarë të Senicës me kryetarin e fshatit të Besëlidhjes, Llambi Nika, Kryepleqësia e Senicës, kryetarin e Shoqatës "Besëlidhja e Vëllazërisë Seniciote", Albert Jorgji si dhe personalitete të tjerë.

Senica e Kuvendit të Besës, me Memorial të ri pret bashkëfshatarë, bashkëkrahinarë, turistë, miq e dashamirës për t'i njohur me burrërinë, unitetin në kohët më të vështira të pushtimit. Të gjithë kujtojnë sot misionin e përmbushur të Kuvendit të Senicës, misionin e bashkimit, të organizimit dhe drejtimit të kundërshtimit dhe përbashkë luftarakle kundër pushtuesve osmanë. Nga Kuvendi i Senicës vijnë mesazhe e vlera uniteti për të gjitha kohrat ku baza e vendimeve të saj ishte: (1) organizimi dhe drejtimi i luftës së bashkuar kundër pushtuesve osmanë për ruajtjen e kufijve dhe sinorëve të të parëve; (2) u vendos me përparësi për dukuritë shoqërore të kohës, kryesisht uniteti ndërmjet besimeve, harmonia dhe mirëkuptimi i ndërsjellë fetar në kundërshti me ligjet e ashpra dhe të egra osmane; (3) u vendos të luftohej kundër bandave kriminale e hajdutëve, që endeshin sa andej-këtej dhe prishnin qetësinë, dëmtonin pronat e pasuritë; (4), në planin social, Kuvendi u shpreh njëzëri kundër fenomenit të gjakmarrjes e hakmarrjes; (5) kuvendi vendosi kundërshtimin e pagesave të taksave dhe tatimeve të shfrenuara osmane; (6), pjesëmarrësit njëzëri ishin kundër dërgimit të djemve askerë në viset e huaja, duke kërkuar që nizamllëku të bëhej në vilajetet shqiptare; (7) u vendos për lidhjen dhe unitetin midis banorëve të krahinave të Jugut të hapësirës shqiptare. Ndërkohë që paria e Kuvendit të Senicës risolli në vëmendjen e të gjithëve ritin e lashtë shqiptar të ritit të ceremonialit të Lidhjes së Besës, ku akti i Besëlidhjes u muarr mbi një shpellë në qendër të Senicës, ku sot është memoriali i derdhur në bronz, duke risjellë edhe një herë besëlidhjen e traditës shqiptare të duarbashkimit që këtë mesazh kaq të lashtë e simbolin e përmban edhe Shoqata "Besëlidhja Seniciote", e mirënjohur për aktivitetet e saj. Labëria në dhjetë shekujt e fundit ka bërë dhjetra kuvende si "Kuvendi i shpellës së Papa Zhulit (1081), Kuvendi i Senicës (1610), i Himarës e Senicës (1770), Kuvendi i Rrapeve të Agait, Taroninë (1773), Progonatit e Picarit (1846), Kuvendi i Mesaplikut (1847), Kuvendi i Gjirokastrës (1880); Kuvendi i Frashërit (1880); Kuvendi i Cepos (1911), Kuvendi i Vlorës 28.11.1912; Kuvendi i Shtëpëzimit (10.4.1914), Kuvendi në Manastirin e Cepos (1911); Kuvendi i Barçallasë (1920); Kuvendi i Kuçit (1924) etj. Çdo kuvend ka fizionominë dhe historinë e tij, vendimet, pjesëmarrësit, aktet sublimë për të drejtën zakonore dhe për luftë kundër pushtuesve dy shtyllat themelore të mbijetesës shqiptare. I tillë ka byrë në histori edhe kuvendi i Senicës. Idriz Sulli dhe Kostë Prifti ditën të shikonin në dritë të syrit rrezikshmërinë e të ardhmes së Kombit Shqiptar dhe pa rezerva mund të themi se i paraprinë mençurisht periudhës së rilindjes së Kombit Shqiptar, jo mbi bazë besimesh fetare, por mbi bazën e lidhjes së gjakut dhe gjuhës kombëtare amtare. Me besim u ruajt i paprekur besimi deri në ditët e sotme. Senica, ku ballkon plot dritë vendosur përreth kishës së Shën Dhimitrit është i vetmi me besimin ortodoks mes shtatë fshatrave të Rrëzomës, por është fshat me rrënjë e lavdi historike, edhe pse Besën Seniciote do ta kujtojmë përherë, për atë çka i dha fshatit, krahinës, Labërisë, Jugut të Shqipërisë dhe mbarë kombit shqiptar.

## SUPLEMENTI LETRAT

Libri i 28-të të Halil Ramës "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave" promovohet me 14 prill 2025 në Kinema "Maks Velo" Laparakë

# Patriotizmi, vlerë e përherëshme e dibranit



**Nga Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj**  
**Mjeshtër i Madh**

**M**e dibranët jam njohur më herët, kur më 14 dhjetor 1967, brenda një dite u hap kanali Selitë-Fushë-Alie-Kandër, 17 km i gjatë dhe grupi polifonik i Smokthinës, Vlorë i ka kënduar këngë "O moj Dibra, heroinë". Kënga është kjo: "O moj Dibra, heroinë/ ngrite peshë Shqipërinë/ iniciativën që more/ me një vepër madhështore/ goditja e përqëndruar/ është një zjarr që s'ka të shuar". (Kënga gjendet në YouTube me këtë titull).

Në vitet '70 të shekullit XX, kur isha me studimet ushtarake u njoha me Bardhyl Hoxhën nga Dibra, i cili më vonë u bë gjeneral i ushtrisë shqiptare. Me dibranët dhe historinë e saj u njoha gjerësisht me vlonjati Ibrahim Shyti që kishte lidhje të ngushtë me "shërbëtorin e kombit" Josif Bageri nga Dibra e Madhe. Më tej kjo lidhje e njohje mori zhvillim me veteranin Pali Carapuli, i cili më dorëzoi për recensë historikun e Dibrës në LANÇ. Me fillimin e shekullit të Ri, krijova lidhje me Bujar Karoshin, i cili drejton "Botimet M&B", si dhe botimin e gazetës "Rruga e Arbërit", ku kam botuar disa shkrime.

Lidhja vijoi me djemtë e talentuar të Dibrës Heroike, Fatos Daci e Sakip Cami. Kështu në vijimësi kam shkruar në Peshkopi dhe kam referuar për Skënderbeun, për betejat e tij në Dibër, për luftën e Dibrës të vitit 1921, për luftimet e kryera gjatë LANÇ, për dëshmorët etj. Në disa libra të autorëve dibranë më është dhënë mundësia për të bërë recensa e për të diskutuar në promovime të librave.

Njohja vijoi me Akademik Shaban Sinani, me prof. Adem Bonguri, me komentatorin sportiv Dëfrim Methasani, Eduart Ramçi, Hysen Uka, me regjizoren Donika Mustafaj, me botuesen Miranda Karoshi, me gjeneralen Manushaqe Shehu, me poetin Demir Rusi, me Zabit Lleshin, me ministren e Arsimit Tefta Cami, me prof. Shpëtim Cami... e mjaft dibranë të tjerë, deri në njohjen me Halil Ramën.

Libri i Mjeshtër të Madh Halil Rama "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave" është një studim i thelluar dhe në kohë, që shpalos portretin e mjaft njerëzve të pazakontë të trevës së lavdishme dibrane. Janë portretizime që vijnë, si nga historia, ashtu dhe njohja e autorit me personazhet historikë.

Autori nuk i ka zgjedhur rastësisht këta dibranë, por ka qenë diçka e brendshme që i ka sjellë tek ai. Mundet të jenë fije të fatit apo të brengave të tij, për vlerat e tyre luftarake, patriotike, historike, artistike e letrare. Mjeshtri Halil Rama ka gjetur në qoshen e përjetshme dhe të pakontestueshme dibrane njerëz që qëndrojnë në panteonin dibran dhe brenda tyre një filozofi si mbartës e si lëvruer modest i portretit historik, por dhe i vlerave të shumta dibrane.

Të shkruash për figura historike dhe që kanë lënë gjurmë në memorien kombëtare, është një sipërmarr-

- **Prodhimtaria historike e letrare e Halil Ramës është e dukshme. Krijimtaria e tij letrare është e hershme në aspektin e letrave, duke dhënë kontribut me vlera në gjinitë letrare dhe në publicistikë. Në këtë libër ai paraqet një dimension me rëndësi të madhe në historinë e letrave, por edhe për faktin se i flet lexuesit të çdo kohe për atdhedashurinë dhe kulturën dibrane e shqiptare. Në rolin e një analisti, ai ka operuar me parametra historik, patriotik, estetik, artistik e kumtor dhe ka pëlqyer stilin e ligjërimit publicistik.**



je e vështirë, plot rreziqe, me risk, pasi pesha specifike e tyre është e madhe. Halil Rama është nga shkrimtarët lëvruer e gërmues për të vënë në dukje, dukuritë më të mira dibrane dhe shqiptare. E gjithë vepra e tij, ndonëse e shkruar në fundshekullin XX dhe në këtë çerekshekull të shekullit XXI, ka fituar vlera të përjetshme në historinë e Dibrës.

Duke bërë disa viza për të vizatuar portretin e Halil Ramës, si njeri, si shkruer i letrave dhe si shkrimtar, kam parasysh një thënie të Bielinskis se "asgjë nuk mund të pohohet mbi bazën e tekave personale, të ndjenjave spontane, as të bindjeve individuale, gjyqi i takon arsyes dhe jo personit dhe personi duhet të gjykohej në emër të arsyes mbarënjerezore".

Lexuesi, ashtu si dhe unë do të jetë i lutur ta kundrojë këtë ese të gjatë, jo si një përsiatje të mirëfilltë në rrafshin e gjykimit historik, teoriko dhe estetik, por si një "çjerrje" për rivlerësimin e disa figurave dibrane. Shumë prej tyre, edhe pse janë të hipotekuar në korpusin e madh të letrave shqipe, kanë mbetur disi të mënjanuar. Autori e ka ndjerë këtë përgjegjësi morale dhe qytetare, dhe ja ka dhënë lexuesit të kur-dokohshëm të lexojë, të rivlerësojë e të shijojë veprën e tyre si shenjë historike e atdhetare, por dhe estetike.

Mjeshtri Halil Rama në rolin e një analisti, ka operuar me parametra historik, patriotik, estetik, artistik e kumtor dhe ka pëlqyer stilin e ligjërimit publicistik.

Prodhimtaria historike e letrare e Halil Ramës është e dukshme. Krijimtaria e tij letrare është e hershme në aspektin e letrave, duke dhënë kontribut me vlera në gjinitë letrare dhe në publicistikë. Në këtë libër ai paraqet një dimension me rëndësi të madhe në historinë e letrave, por edhe për faktin se i flet lexuesit të çdo kohe për atdhedashurinë dhe kulturën dibrane e shqiptare.

Qëllimi i këtij libri dhe i autorit nuk është të analizojë të gjithë veprimtarinë e dibranëve, as të ndalet në ndonjë nga veprat e tyre të shumta, por për të prurë në këtë kohë individë që në jetë kanë shpalosur ditu-

ri, patriotizëm dhe qëndresë. Është koha të kthejmë sytë nga patriotizmi, që është një vlerë e përherëshme e dibranit dhe shqiptarit në shekuj. Halil Rama në këtë kohë të trazuar ka ditur dhe gjetur pozicionin e duhur, duke bërë luftën e tij me penë.

Libri është ndarë në gjashtë kapituj.

Në kapitullin e parë na ka sjellë personalitete të krenarisë kombëtare, duke bërë një portretizim të mjaft figurave që kanë zënë vend në kështjellën shqiptare dhe të tjerë që i janë bashkuar kësaj kështjelle. Ai ka analizuar rrethanat, figurën dhe gjurmët e tyre të lënë në jetë, duke na i sjellë për të biseduar dhe marrë vendime për të ardhmen.

Nëpërmjet një studimi të tillë, me pak faqe autori dritëson ngjarje, bëma dhe një qëndresë epike të mjaft figurave patriotike dibranëve si Dine Hoxha filozof popullor; Ahmet Fetah Cami, atdhetari në dy luftëra botërore; Emin Cibaku dëshmor i rënë në betejën e Kolesjanit; Harun Domi, patriotit që pruri abetaren në Kalis e Kala të Dodës dhe Edip Daci, ushtaraku që refuzoi betimin fashist.

Më tej autori sjell një galeri të madhe dibrane; Hamit Koçi, intelektualit patriot i Vajkalit; Artan Cuku, dëshmor i demokracisë; Adem Islam Hoxha nga Çidhna që ra më 2 gusht 1949. Prof. Shpëtim Cami, "koherent me ato çka thotë e bën" për librin "Koherencë"; Dinastia e vëllezërve Keta nga Bulqiza, kampionë bote në kikkboks; Defrim Methasani, ikonë e gazetarisë sportive, dokumentarit televiziv dhe moderuesit të mjaft eventeve.

Mjeshteri Hali Rama ka vijuar me një përshkrim të mjaft figurave dibrane që kanë bërë emër në historinë shqiptare.

Në përshkrimin e figurave të tilla autori me plot meritë ka derdhur talentin e tij, duke gdhendur deri në detaje çdo figurë të Dibrës, për t'i dhënë më tej shkëlqimin dritës dibrane dhe ja ka arritur.

(Vijon në faqen 15)

## SUPLEMENTI LETRAT

## Rruga e Arbrit

Poemth nga Sakip Cami

E moçme sa vetë Arbri  
Mbi trupin tënd karvanë pambarim  
Kaluan shekuj, emri mbeti  
Se mbretërit të çuan në harrim.

Është rrugë e shkurtër për hasmin  
Na mbin në derë menjëherë  
Prandaj të mbyllet u muar vendimi  
Mos hapet asnjëherë.

Rrugën e Arbrit, rrugën e Dibrës  
Nuk e bllokoi dot asnjë qeveri  
Nëpër ura të larta edhe tunele  
Rruga për te zemrat çau çdo kufi.

Hej ju dibranë të përtej Drinit  
Për një orë ejani në Tiranë  
Dibra u bashkua në dy anët e Drinit  
Tunelet dhe urat ja dolën an'e mbanë.

Te Ura e Vashës flet historia  
Malin e Murrizit mposhti drita e Diellit  
Te Ura e Drinit, zemrën ka Shqipëria  
Djathtas në Shehër, lodra në kupë të qiellit.

Te Ura e fshatit drejt në tunel  
Nga ura e Vashës prapë në tunel  
Nga tuneli në tunel  
Vargu i makinave hyn edhe del.

Shkallë e Tujanit, kreshnikja shkallë  
Sa shumë karvane përcolle me sy  
Sa shumë armiqe u bëre ballë  
Por jo rrugës së re, rrugës Arbërisë.

Moj Ura e Vashës  
Më e larta në Ballkan  
Dikur varri i pashës  
Sot na bën krenar.

Moj Ura e Fshatit  
S'je më për një fshat  
Sot ti lidh dy shtete  
Ëndrrat tona zgjat.

Moj Ura e Drinit  
Drinit që shëndrrin  
Tiranë – Peshkopi  
Për një orë mbërrin.



Hej more tunel  
Tuneli i Murrizit  
Të lodhëm, na lodhe  
Ta shtruum kurrizin.

Rruga e Planit Bardhë  
Gjarpëron n'luginë  
Ca e mbajnë në Tiranë  
Ca në Bulqizë, shtëpinë.

Akull, ujë i ftohtë  
Gurrat pa mbarim  
Shijojeni o njerëz  
Pëllëmbë e blerim.

Ta gëzojmë Rrugën e Arbrit  
Ta gëzojmë ditën e verës  
Mbaroi dimri i ashpër  
Shëndrrit lulja e pranverës.



## Patriotizmi, vlerë e përhershme e dibranit

(Vijon nga faqja 14)

Në kreun e dytë përshkruan personalitete të arsimit dhe kulturës me Lutfi Hanku, mësuesi e shkrimtari disident; Muharrem Xhediku, kompozitori i tangos shqiptare; Hazis Ndreu, ezopi i Dibrës; Liri Rasha, pasaporta artistike e Dibrës; Qerim Sula, zëri i lavdisë shekullore dhe ikonë e këngës dibrane; poeti i këngës, Naim Plaku; Muharrem Gjoka, promovues i vlerave etnokulturore; Lahim Kola, muzikanti i talentuar; Osman Miha për arsimin profesional në Bulqizë; Skënder Murrja, për 40 vjet mësues dhe drejtor shembullor i disa shkollave dhe Dritan Jashari me këngën “kjo është Dibra maja-maja”.

Në kreun e tretë me objekt “për ushtrinë shqiptare” nis me gjeneralin e lavdishëm Dali Ndreu, strategu që drejtoi luftën për çlirimin e Tiranës; Ismail Shulku, nderimi për ish-komandantin e frontit verilindor; Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare me gradën madhore “gjeneralmajor”; Selman Rama, skëndebe-gasi nga Muhurri që u bë oficer marine; Hamdi Doda, gjenerali nga Muhurri që ka përfaqësuar Shqipërinë në NATO dhe Klodian Tanushi, portreti në bronx i dëshmorit.

Kreu i katërt përfaqësohet me elitën mjekësore shqiptare duke nisur me Dr. Mehdi Cani, misionar i mjekësisë shqiptare; Prof. Dr. Petrit Bara, personalitet i shquar i mjekësisë; Prof. asc. Islam Dauti, intelektual i shquar me përmasa mbarëkombëtare; Prof. Asoc.

Dr. Ali Tonuzi, më i vlerësuar nga pacientët dhe elita mjekësore; Dr. Ajet Xhafa, kirurugu urolog duarartë nga Bulqiza, në spitalin amerikan të Prishtinës.

Në kreun e pestë përshkruhen disa nga librat e autorëve dibranë të shkruar për historinë e Dibrës, ku një vëmendje i kanë kushtuar figurës së Skënderbeut. Kështu autorët Naim Berisha që ka shkruar për Berishët e Muhurrit si rast unik në historinë skënderbegiane; Besnik S. Kebej, origjina dibrane e Skënderbeut; Fatos Daci, Skënderbeu ka lindur në Sinë të Dibrës.

Më tej vijon me Prof. Saimir Shatku, për “Atdhetarët Shatku”, më Prof. Dr. Fatmir Terziu, Toponimia e Gollobordës, diskursi i dygjuhësisë dhe derivati i origjinës; me Sakip Cami, ngjarje dhe figura të shquara historike të komunitetit të bashkisë së Bulqizës (1839 – 1939); Hysen Dervishi, “luftëtari i lirisë” për patriotin dibran Rrahman Dervishi; Haki Permezha dhe Rruzhi Bitri, “toponimia e Çidhnës”; Faik Bruçi, “fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës”; Kamber Faruku, “kur po shkriheshin akujt”. Autori ka bërë një përshkrim të rëndësishëm lidhur me botimin e këtyre librave me vlera për mjaft aspekte të jetës dibrane, por dhe të shoqërisë shqiptare.

Në kreun e gjashtë trajton “Dibra dhe dibranët në reportazhe të autorit”, ku vend zënë: Bulqiza në një film të Ylli Pepos, aty ku banorët shkelin mbi nëntokën më të pasur në Europë; Përrurimi i memorialit, eksodi masiv, mijëra familje dibrane në këmbë drejt Tiranës;

“Sarina 2002”, lider në arsimin jopublik shqiptar; Feshtë në fshatin e martirizuar, Viçishti, fshati aty ku ka më shumë heronj se dëshmorë; Dita e Maqellarës... Diaspora dibrane, festë në Dibër të Madhe dhe Fuqia e fjalës së shkruar në ruajtjen e identitetit kulturor.

Libri është një prurje e re për Dibrën, e cila në histori ka bërë që zëri i bijve të saj të dëgjohet në Shqipëri. Libri vjen si një pikënisje për të gjithë patriotët që kanë bërë dhe shkruar histori në jetën shqiptare. Në këtë madhështi të figurave dibrane, Halil Rama, vjen si një zë i veçantë dhe me përmasa, që lartëson dhe i jep dinjitet figurave dibrane, ku fama e tyre është dëgjuar në kontinentin Europian dhe më gjerë.

Libri i Halil Ramës është shkruar thjeshtë, me zemër, me një gjuhë që përcjell mesazhe nën petkun e një mendimi filozofik dhe historik të epër, me dashuri e përkushtim për Dibrën e për Atdheun dhe shpirtin e tyre lridashës. Për të gjitha këto ese dhe përshkrime mjeshtërisht prej Halil Ramës, duhet t'i jemi mirënjohës për vlerat krijuese të tij.

Historia e një kombi është e gdhendur në veprat dhe sakrificat e bijve e bijave të tij më të përkushtuar, por prurjen në jetë dhe plotë dritë të këtyre figurave të shquara dibrane, e ka bërë Mjeshtëri i Madh, Halil Rama, i cili zë një vend të veçantë në historinë e kombit shqiptar.

Tiranë, më 6 mars 2025.

## FOTOREPORTAZH

# “PËR TË GJITHA GRATË & VAJZAT – TË DREJTA, BARAZI, FUQIZIM”



## TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU “AMBASADORE PËR PAQE”

(Vijon nga faqja 3)

në familjen europiane. Gjithashtu do të punojmë pa u lodhur që brezat e rinj të njohin historinë e lavdishme të popullit shqiptar, të duan jetën, të duan njëri-tjetrit, të vlerësojnë dhe mbrojnë familjet e tyre dhe paqen kudo në botë”, - e përfundoi fjalën e saj përshëndetëse kryetarja e OBVLP-së.

**“PËR TË GJITHA GRATË & VAJZAT – TË DREJTA, BARAZI, FUQIZIM”**

Veprimtarisë festive në sallën ko-

mode të Amasadës së Paqes në Tiranë me temë “PËR TË GJITHA GRATË & VAJZAT – TË DREJTA, BARAZI, FUQIZIM” ia shtoi kuptimin dhe vlerën moderatorit dhe gazetari i mirënjohur z. Defrim Methasani, Kryetari i Federatës së Paqes Universale Shqipëri me mjeshtrinë e fjalës së tij. Fjalët përshëndetëse i mbajtën dy organizatorët e veprimtarisë, znj. Katerina Minolari dhe z. Kastriot Selita, repektivisht Kryetare e Federatës Shqiptare të Grave për Paqe dhe Kryetar i Këshillit Rajonal të Paqes Tiranë. Surprizë e këndshme ishte vlerësimi i znj. Katerina Minolari

nga Federata e Paqes dhe ajo e Familjes me çmimin e MIRËNJOHJES për investimin e saj 25 vjeçar në Shqipëri.

Vajzat, zonjat, gratë, nënat dhe gjyshet prezente në veprimtari të përshëndeti me një buqetë këngësh plot energji këngëtarja e mirënjohur e muzikës popullore, tashmë Ambasadore për Paqe, artistja Valbona Halili. Dy zonja të nderuara, Ambasadore për Paqe, Prof. Asoc. Dr. Eva Allushi – Nënkryetare e Asamblesë së Federatës së Paqes Universale Shqipëri dhe Av. Dorina Prethi – Avokate dhe përfaqësuese e grave të reja në politikë, mbajtën një fjalë rasti

mbi të drejtat e grave dhe nevojën për më shumë përpjekje për të arritur barazinë e vërtetë mes burrave dhe grave, në kuptimin që ata janë të barabartë në vlerë dhe plotësues të njëri-tjetrit në cilësitë unike të personalitetit dhe karakterit. Pjesëmarrësit i përshëndeti me disa poezi të bukura për gruan edhe poetesha e mirënjohur znj. Zhuljeta Grabocka. Në fund, Sekretarja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Grave për Paqe znj. Eranda Haziraj falenderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen dhe i inkurajoi të bënin më shumë për të mbështetur njëri-tjetrit.